

RAPORTI  
VJETOR

**2013**

## SHKURTIMISHT

# 2011

### INVESTIMET

Fondet e BNY Mellon dhe Aquila Capital shtohen për të diversifikuar tutje pjesën e mjeteve me menaxhim aktiv. Vit i dobët për siguracionet në SHBA.

Kthimi neto për vitin ishte 0.2%, dhe mjetet nën menaxhim u rritën për 20.4%.

# 2012

Investimet e para në fletobligacione të Kosovës. Në portofol shtohen aksionet nga tregjet në zhvillim. Vit i mirë për të gjitha klasat e mjeteve.

Kthimi neto për vitin ishte 8.0%, dhe mjetet nën menaxhim u rritën për 25.8%.

# 2013

Përmirësim domethënës i politikës investuese. Një vit jashtëzakonisht i mirë për aksionet në vendet e zhvilluara, veçanërisht në SHBA.

Kthimi neto për vitin ishte 8.5%, dhe mjetet nën menaxhim u rritën për 23.4%.

### OPERACIONET

Shfrytëzimi i Sistemit Ndërbankar të Kliringut të BQK-së për barazimin e pagesave të kontributeve nga punëdhënësit.

Kontributet e pa-alokuara u reduktuan në 3.2% të kontributeve të arkëtuara.

Filloi përlllogaritja ditore e çmimit të aksionit dhe migrimi në softuerin e ri për menaxhimin e llogarive të kontribuuesve.

Kontributet e pa-alokuara u reduktuan në 2.4% të kontributeve të arkëtuara.

Implementimi Planit të përmirësuar për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë, dhe përditësimi automatik i fakteve kyçe në ueb.

Kontributet e pa-alokuara u reduktuan në 1.5% të kontributeve të arkëtuara.

## PËRMBAJTJA

<b>01</b>	<b>PARATHËNIE NGA KRYESUESI I BORDIT DHE DREJTORI MENAXHUES</b>	Faqe 05
<b>02</b>	<b>ORGANIZATA DHE FINANCAT</b> Bordi Administrata Mbikëqyrja dhe auditimi Financimi Shpenzimet	Faqe 07 Faqe 07 Faqe 10 Faqe 11 Faqe 12 Faqe 13
<b>03</b>	<b>AKTIVITETET</b> Aktivitetet e Bordit Menaxhimi i llogarive Barazimi Shërbimet për klientë	Faqe 15 Faqe 15 Faqe 16 Faqe 17 Faqe 18
<b>04</b>	<b>INVESTIMI I KURSIMEVE PENSIONALE</b> Parimet dhe politika investuese Shpërndarja e mjeteve Performanca e investimeve	Faqe 19 Faqe 20 Faqe 21 Faqe 25
<b>05</b>	<b>KONTRIBUTET DHE PENSIONIMET</b> Fillimi dhe pasivizimi i kontribuimit Kontributet Pensionimet dhe pagesat e benefiteve	Faqe 27 Faqe 27 Faqe 28 Faqe 29
<b>06</b>	<b>KUSH JANË KONTRIBUESIT?</b>	Faqe 31
<b>07</b>	<b>PASQYRAT E AUDITUARA FINANCIARE PËR FKPK-OPERACIONET</b>	Faqe 39
<b>08</b>	<b>PASQYRAT E AUDITUARA FINANCIARE PËR FKPK-MJETET PENSIONALE</b>	Faqe 61

Mjetet pensionale neto janë rritur për

**257%**

prej vitit 2008.

Mjetet e menaxhuara nga FKPK-ja kanë arritur në

**19.4%**

të BPV-së së Kosovës.

Investimet gjatë pesë vjetëve të fundit kanë arritur kthim bruto në investime prej

**€201.4 mln**


ndërkohë që çmimi i aksionit është rritur

**40.8%**


gjatë periudhës së njëjtë.

**SHËNIM:** Vlerat e mjeteve pensionale në këtë Raport Vjetor nuk i përfshijnë kontributet dhe të arkëtueshmet tjera prej €7.87 mln (2012: €7.79 mln).


MJETET PENSIONALE NETO



KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET




KONTRIBUTET KUMULATIVE TË PA-ALOKUARA



FKPK-ja, me zyrën e saj në Prishtinë, është fondi i vetëm pensional në Republikën e Kosovës që menaxhon me kontributet e detyrueshme për kursime pensionale të të punësuarve të Kosovës.



Gjatë vitit 2013 çmimi i aksionit ka vazhduar të rritet me një trend përafërsisht të njëjtë sikurse në vitin paraprak.



## MISIONI DHE AMBICIA

Misioni ynë është t'i investojmë kursimet pensionale dhe t'i administrojmë llogaritë individuale të kontribuuesve deri në pensionimin e tyre. Ne përpiqemi që misionin tonë ta arrijmë përmes investimeve të matura të mjeteve dhe procese të efektshme administrative.

Ambicia jonë është që të ofrojmë shërbimet më të mira të mundshme për kontribuuesit si dhe të jemi institucioni më i besuar në Kosovë. Ambicien tonë përpiqemi ta arrijmë përmes profesionalizmit dhe integritetit të stafit si dhe transparencës institucionale.

## PËRMBLEDHJE E TERMAVE

<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BPV</b>	Bruto Prodhimi Vendor (publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës)
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
<b>DPD</b>	Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve, Ministria e Punëve të Brendshme
<b>FKPK</b>	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
<b>KUVENDI</b>	Kuvendi i Republikës së Kosovës
<b>QEVERIA</b>	Qeveria e Republikës së Kosovës
<b>SNRF</b>	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
<b>OBZHE</b>	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

## PARATHËNIE NGA KRYESUESI I BORDIT DHE DREJTORI MENAXHUES

Kemi kënaqësinë të raportojmë se kthimi bruto nga investimet për vitin 2013 prej €71.1 mln ishte kthimi nominal më i lartë në historikun e FKPK-së. Performanca neto për vitin ishte 8.5%, njëherësh performanca neto e tretë më e mirë qysh prej themelimit të FKPK-së më 2002. Alokimi i mjeteve në llogaritë e kontribuuesve prej €123.1 mln ishte më i larti ndonjëherë; ndërkohë që kontributet kumulative të pa-alokuara ranë ndjeshëm në €12.8 mln.



Viti 2013 shënon një numër shumë të rëndësishëm arritjesh për FKPK-në. Çmimi i aksionit në fund të vitit ishte €1.2117, i rritur për 8.5% krahasuar me €1.1170 sa ishte në fund të vitit 2012.

Kjo performancë investuese shënon pesë vjet radhazi, dhe njëmbëdhjetë nga dymbëdhjetë vjet prej themelimit, të kthimeve pozitive për mjetet pensionale.

Duke iu afruar gjithnjë e më tepër 1 miliard eurove, mjetet pensionale nën menaxhim të FKPK-së në fund të vitit 2013 ishin €913.2 mln. Ato përbëheshin nga: €115.5 mln (ose 12.6%) nga të ardhurat prej investimeve (vlera që i është shtuar fondit përmes investimeve) – më e larta historikisht; dhe €797.7 mln (ose 87.4%) nga kontributet nominale të arkëtuara (kontribute të cilat vazhdojnë të menaxhohen nga FKPK-ja).

Sikurse vitin e kaluar, një numër rekordesh u thyen gjatë 2013-s: kontributet e arkëtuara €119.2 mln; kontributet e alokuara €123.1 mln; kthimi bruto nga investimet €71.1 mln; pagesa të benefiteve €10.7 mln. Përveç këtyre, niveli i tarifave menaxhuese vjetore (tarifës për investime dhe asaj për operacione), është reduktuar në 0.53% – nivelin më të ulët prej themelimit.

Për më tepër, nga fundi i vitit Bordi dakordoi politikën dhe kornizën e re investuese. Ky ndryshim do të rezultojë në diversifikimin e investimeve jo vetëm në klasë të ndryshme të mjeteve por edhe në qasje të ndryshme; me synim kryesor – mbrojtje më të mirë kur tregjet janë në rënie, por duke vazhduar së përfituari kur tregjet ngriten.

**YMER HAVOLLI**  
Kryesuesi i Bordit

**ADRIAN ZALLI**  
Drejtori Menaxhues

Arritjet e Administratës gjatë vitit po ashtu duhen përmendur. Veçanërisht kur flitet për trajtimin e kontributeve të pa-alokuara nga vitet paraprake.

Totali i kontributeve të pa-alokuara u mbyll në €12.8 mln, që ishte ndjeshëm më e ulët sesa vlera prej €17.5 mln në fund të vitit të shkuar. Kjo ishte e mundur të arrihet vetëm falë përkushtimit të stafit të FKPK-së për të siguruar sa më shumë raporte që nuk ishin dorëzuar nga punëdhënësit për kontribute.


Përtej kësaj, identifikimi proaktiv i ndëshkimeve dhe interesave të paguara së bashku me kontributet pensionale (të ashtuquajtura “kontribute të gabuara”), ka qenë sistematik përgjatë vitit. Kjo është arritur përmes konsultimit të të dhënave relevante nga sistemi i ATK-së gjë që ka mundësuar refondim më të shpejtë të kontributeve të gabuara; duke ndihmuar kështu në reduktimin e kontributeve të pa-alokuara.

Megjithatë, projekti administrativ më i rëndësishëm i vitit ishte përmirësimi i planit të Rimëkëmbjes pas Fatkeqësive dhe implementimi i tij. Infrastruktura dytësore e nevojitur sipas këtij plani (hardueri, softueri dhe zyra), është siguruar dhe vënë në përdorim plotësisht, si dhe plani është testuar me sukses gjatë vitit.

Shfrytëzojmë këtë rast për t'i falënderuar BQK-në, ATK-në dhe DPD-në për mbështetjen e tyre logjistike dhe procedurale të cilën vazhdojnë t'ia ofrojnë FKPK-së.

## ORGANIZATA DHE FINANCAT

FKPK-ja është themeluar si institucioni i vetëm për menaxhimin dhe investimin e kontributeve të detyrueshme pensionale të të punësuarve të Kosovës, si dhe administrimin e llogarive të tyre individuale të kursimeve pensionale deri në pensionimin e tyre.



FKPK u themelua me Ligj në dhjetor të vitit 2001 si institucion jo-për-profit. Si i tillë, qëllimi i vetëm i FKPK-së është t'i shërbejë **vetëm** interesit më të mirë të kontribuuesve të saj.

FKPK u funksionalizua në tërësi me Bord, Administratë dhe vendosje të proceseve në gusht 2002. Asokohë, Administrata numëronte 22 punonjës dhe kishte vetëm pesë departamente. Që nga atëherë, Administrata në mënyrë organike ka evoluar në 26 punonjës dhe shtatë departamente.

Gushti i vitit 2002 ishte po ashtu muaji në të cilin u arkëtuan kontributet e para nga punonjësit e sektorit publik. Më 2003, të vetë-punësuarit dhe personat e punësuar në sektorin privat po ashtu iu bashkangjitën kursimit.

Investimi i parë i mjeteve pensionale u bë gjatë vitit 2003 në fonde të parasë së gatshme. Kjo u pasua në 2004 me investime në aksione të indeksuara dhe në 2006 me investime në instrumente të borxhit. Më tej, investimet u zgjeruan për të përfshirë fondet multi-asetëshe më 2010, ndërkaq fondet me target riskun më 2011.

### Bordi

Të mirëbesuarit për mjetet pensionale

FKPK-ja qeveriset nga Bordi, anëtarët e të cilit emërohen nga Kuvendi si të mirëbesuarit për mjetet pensionale.

Ligji Nr. 04/L-101 i Republikës së Kosovës për fondet pensionale në Kosovë, bashkë me amandamentet e tij, shtjellon detajisht funksionimin dhe përgjegjësitë e FKPK-së dhe Bordit të tij. Rregullat Pensionale të BQK-së nxjerrin legjislacionin dytësor në lidhje me, në mes të tjerash, investimin e mjeteve pensionale, matjen e performancës, dhe kërkesat për raportim të FKPK-së.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit përfshijnë, por nuk kufizohen në: përzgjedhjen ose largimin e menaxhuesve të mjeteve, kujdestarëve, fondeve të hapura për investime si dhe palëve të tjera të treta; miratimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; punësimin e personelit ekzekutiv të FKPK-së; miratimin e pasqyrave financiare të FKPK-së.

Bordi mund të ketë shtatë anëtarë me të drejtë vote, dhe një anëtar pa të drejtë vote që përfaqëson Qeverinë.

Së paku pesë nga anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë profesionalë, me së paku dhjetë vjet përvojë në fushën e investimeve ose të menaxhimit të fondeve pensionale; së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëmarrësve në Kosovë, dhe së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëdhënësve të Kosovës.

Në fund të 2013-s në përbërjen e Bordit mungonte anëtari i cili do të përfaqësonte interesat e punëdhënësve të Kosovës, si dhe anëtari pa të drejtë vote, i cili do të përfaqësonte Qeverinë.

Anëtarët e Bordit përzgjidhen me mandat tre-vjeçar me të drejtë të rizgjedhjes.

## Anëtarët e Bordit në fundvit

Pozitat e përfaqësuesit të punëdhënësve dhe të Qeverisë ishin bosh gjatë vitit



### DR. YMER HAVOLLI

Kryesues i Bordit dhe anëtar i Komisionit për Investime dhe për Buxhet

Profesor i Asocuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gradën e doktorit të shkencës ekonomike për menaxhimin e BNJ

- Profesional
- Maj 2009
- I dytë
- Korrik 2015



### Z. FREDERICK ARTESANI

Kryesues i Komisionit për Investime dhe anëtar i Komisionit të Auditimit

Ekonomist dhe Këshilltar i pavarur financiar, i regjistruar në Komisionin Spanjoll të Tregut Financiar (CNMV)

- Profesional
- Tetor 2008
- I dytë
- Tetor 2014



### Z. ALAN PICKERING

Kryesues i Komisionit për Buxhet dhe anëtar i Komisionit për Investime

Kryesues i *BESTrustees, Life Academy, Plumbing Industry Pension Scheme*. Drejtor jo-ekzekutiv i Rregullatorit të Pensioneve në MB

- Profesional
- Gusht 2012
- I parë
- Korrik 2015



### Z. LEENDERT VAN DRIEL

Kryesues i Komisionit të Auditimit dhe anëtar i Komisionit për Investime

Drejtor i një kompanie këshilluese për menaxhimin strategjik të riskut. Më parë ishte mbikëqyrës në Bankën Qendrore të Holandës

- Profesional
- Gusht 2012
- I parë
- Korrik 2015



### DR. DRITON QEHAJA

Anëtar i Komisionit për Investime dhe për Ankesa

Profesor i Asocuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gradën e doktorit të shkencave ekonomike dhe sociale

- Profesional
- Gusht 2012
- I parë
- Korrik 2015



### MR. SC. RUZHDI MORINA

Kryesues i Komisionit për Ankesa dhe anëtar i Komisionit për Auditim

Këshilltar Ligjor në Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës dhe Bashkëpunëtor në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës

- Përfaqësues i Punonjësve
- Maj 2009
- I dytë
- Korrik 2015

#### LEGJENDA

- Lloji i anëtarit
- Emëruar
- Mandati aktual
- Mandati skadon

## Bordet e emëruara nga Kuvendi

I pari

2002

I dyti

2005

I treti

2009

I katërti

2012

## Komisionet

Katër komisione mbështesin funksionimin dhe vendimmarrjen e Bordit

**Komisioni i Investimeve** kryesisht shqyrton politikën, parimet dhe strategjinë e investimit të mjeteve pensionale, ashtu sikurse performancën e investimeve dhe fondeve të hapura investuese përmes të cilave FKPK-ja investon mjetet. Komisioni e shqyrton gjithashtu edhe pajtueshmërinë e investimeve me kërkesat ligjore dhe të rregullatorit. Komisioni i bën rekomandime Bordit për investimin e mjeteve pensionale.

- Frederick Artesani
- Ymer Havolli  
Alan Pickering  
Leendert van Driel  
Driton Qehaja
- Pesë

**Komisioni i Auditimit** në mesin e shumë funksioneve shqyrton raportet e rregullatorit dhe auditorit, dhe i rekomandon Bordit ndërmarrjen e planit të nevojshëm të veprimit për t'i trajtuar gjetjet dhe çështjet. Komisioni po ashtu shqyrton përshtatshmërinë e procedurave të brendshme, dhe në rast nevojë rekomandon ndryshime. Komisioni i vlerëson gjithashtu planet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, dhe i rekomandon Bordit aprovimin e tyre.

- Leendert van Driel
- Frederick Artesani
- Ruzhdi Morina

Katër

**Komisioni për Ankesa** shqyrton kërkesat, pretendimet dhe ankesat e kontribuuesve të cilat i drejtohen Bordit ose FKPK-së në tërësi. Komisioni ia paraqet Bordit rekomandimet dhe siguron që të gjitha rasteve t'iu jepet përgjigje brenda afateve ligjore dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

- Ruzhdi Morina
- Driton Qehaja
- Katër

**Komisioni për Buxhet** shqyrton nevojat buxhetore të FKPK-së dhe sipas tyre i jep rekomandime Bordit për nivelin e tarifave që duhet të ngarkohen mbi mjetet pensionale. Komisioni gjithashtu i rekomandon Bordit miratimin e buxhetit dhe, kur ka nevojë, ndryshimeve në buxhet. Komisioni po ashtu shqyrton shpenzimet e FKPK-së kundrejt buxhetit.

- Alan Pickering
- Ymer Havolli
- Driton Qehaja
- Tre

# 2011

Viti kur komisionet u funksionalizuan

#### LEGJENDA

- Kryesues
- Anëtarët e tjerë
- Takime të mbajtura

## Administrata

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendës drejtorë

Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe moralisht të shëndoshë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të madh, mjedis të shëndoshë pune, dhe përfundimisht, në shërbime më të mira për kontribuuesit; dhe njëkohësisht, të ruhet integriteti institucional i FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi dhe Menaxhmenti, që të dyja sigurojnë që Administrata aktuale të vazhdojë t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën e saj, të vazhdojë të jetë shumë e motivuar, drejt shfrytëzimit të plotë të kapaciteteve.

Administrata është e ndarë në departamente funksionale për të siguruar efektivitet dhe efikasitet në punë. Përmirësimi i proceseve administrative, dhënia e ndihmës Bordit për analizën e investimeve, si dhe implementimi i vendimeve të Bordit janë detyrat kryesore të Administratës. Performanca e kësaj të fundit kontrollohet dhe vlerësohet në vazhdimësi nga Bordi.

Rritja e numrit të stafit konsiderohet si mjete i fundit. Përkundër faktit që të gjitha departamentet dhe të gjithë punonjësit janë angazhuar me kapacitet të plotë përgjatë dy vjetëve të shkuar, nuk ka pasur kërkesë për rritje të stafit gjatë 2013-s.



FKPK-ja i merr shumë seriozisht obligimet e saj jo-diskriminuese dhe është një punëdhënëse që ofron mundësi të barabarta. Punonjësit pjesëtarë të minoriteteve përbëjnë 8% të fuqisë punëtore (9% të atyre që e kanë deklaruar përkatësinë etnike).

Qarkullimi i stafit të përhershëm gjatë 2013-s ishte 0.0% (2012: 7.7%), pasi nuk kishte shtim e as largim të punonjësve të përhershëm.

Për vitin 2013, sikurse një vit më parë, punonjës të përhershëm në FKPK ishin 25 me kohë të plotë dhe 1 me orar të pjesshëm EKP-ja e të cilit ishte 0.51. Ekuivalenti i Kohës së Plotë (EKP) është standard për matjen e fuqisë punëtore të angazhuar për një periudhë të caktuar.

Tri nga tetë femrat punonjëse shkuan në pushim lehonie në mes të marsit dhe gushtit 2013, duke bërë që EKP të bie me 1.69. Menaxhmenti, për të siguruar vazhdimësinë në vendin e punës, vendosi që zëvendësimi i tyre të bëhet përmes angazhimit të përkohshëm të tri praktikanteve, EKP e të cilave ishte 1.83.


Puna jashtë orarit gjatë 2013-s ishte 0.24 EKP, duke bërë që totali i EKP-së për stafin të jetë 25.89 (2012: 26.20).

Mosqarkullimi i të punësuarve të përhershëm rezultoi që të mos ketë ndryshime as në përbërjen etnike e as gjinore të punonjësve. Megjithatë, të gjithë punonjësit janë moshuar për një vit gjatë kësaj kohe, duke e ngritur moshën mesatare për një, në 39.3 vjeç.

Femrat përbëjnë 31% të fuqisë punëtore; 77% e stafit ishin më të vjetër se 35 vjet, dhe 4% e stafit ishin me aftësi të kufizuara fizike të përhershme.

### LEGJENDA

Etnia: Shqiptar Turk Boshnjak Pa deklaruar Me aftësi të kufizuara:



**7** Numri total i auditimeve dhe inspektimeve vjetore gjatë 2013-s dhe 2012-s

Auditimi i Brendshëm Tremujor BQK Gjashtëmujor Auditimi i Jashtëm Vjetor

## Mbikëqyrja dhe auditimi

FKPK-ja mbikëqyret dhe inspektohet nga BQK-ja, dhe i raporton Kuvendit. Ajo auditohet nga auditori i brendshëm dhe i jashtëm

FKPK-ja, si një institucion publik i pavarur, është subjekt i mbikëqyrjes dhe auditimit nga institucione publike dhe private profesionale. Të gjitha këto mbikëqyrje dhe kontrole financiare, nga të cilat nuk ka rezultuar asnjë gjetje serioze, kanë shtuar tutje besimin e Bordit në Menaxhmentin. Njëkohësisht, Bordi beson se këto mbikëqyrje bashkë me performancat e fundit kanë sfiduar kredibilitetin dhe rritur besimin e publikut të gjerë në vendimarrjen e Bordit dhe punën e Menaxhmentit.

Çdo tremujor FKPK-ja i njofton BQK-në, Kuvendin dhe Qeverinë për plasmanet e fondeve pensionale, investimet e reja, kthimin nga investimet, por edhe për harmonizimin e mjeteve pensionale. Ky informacion publikohet gjithashtu edhe në uebfaqen e FKPK-së për konsum të gjerë.

FKPK-ja po ashtu i raporton në baza tremujore BQK-së mbi përputhshmërinë e investimeve me dispozitat ligjore dhe Rregullat e BQK-së për pensionet. Në rast se investimet e FKPK-së, për shkak të lëvizjeve në tregjet financiare, rastisin të mos jenë në pajtim me ligjin, atëherë FKPK-ja është e obliguar që menjëherë ta njoftojë BQK-në, dhe ka afat prej 180 ditësh për ta sanuar gjendjen. Gjatë vitit 2013 nuk kishte raste të tilla.

Më 15 shkurt të çdo viti, FKPK-ja i njofton BQK-në, Kuvendin dhe Qeverinë për shpenzimet investuese të vitit paraprak. Ky informacion gjithashtu publikohet në uebfaqen e FKPK-së.

Deri më 31 maj të çdo viti, FKPK-ja e përpilon dhe e dërgon në BQK, Kuvend dhe Qeveri Raportin

Vjetor për vitin paraprak, së bashku me Pasqyrat Financiare të audituara nga një auditor i pavarur i cili i përgjigjet vetëm pas pëlqimit të BQK-së. Ky informacion publikohet në uebfaqe, po ashtu.

Gjatë vitit BQK-ja e ka finalizuar inspektimin për vitin 2012, ku një numër i madh i dokumenteve është shqyrtuar; që nga procesverbalet e mbledhjeve të Bordit dhe Komisioneve e deri tek të gjitha çështjet administrative. BQK-ja normalisht kryen dy inspektime të FKPK-së brenda vitit, dhe ia raporton gjetjet Bordit. Në rast të gjetjeve serioze BQK-ja duhet gjithashtu t'i raportojë Kuvendit, një veprim i cili deri më tani nuk ka qenë i nevojshëm.

FKPK-ja e ka të punësuar një auditor të brendshëm i cili i raporton katër herë në vit Komisionit të Bordit për Auditim mbi të gjitha aspektet e aktiviteteve të institucionit, duke i dhënë kështu Bordit siguri për cilësinë dhe progresin e aktiviteteve në FKPK.

FKPK-ja e njofton BQK-në edhe për të gjitha vendimet e Bordit që kanë të bëjnë me kontribuuesit, qeverisjen e fondit, dhe çështjet të tjera. BQK-ja, si organ rregullues dhe mbikëqyrës i fondeve pensionale të Shtyllave II dhe III në Kosovë është gjatë gjithë kohës e informuar për aktivitetet e FKPK-së.

Kryesuesi i Bordit po ashtu i ka raportuar Komisionit të Kuvendit për Buxhet dhe Financa si dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, dhe që të dyja këto komisione e kanë mbështetur plotësisht miratimin nga Kuvendi të Raportit Vjetor të FKPK-së për vitin 2012.

## Financimi

### Aktivitetet e FKPK-së kryesisht financohen nga tarifat e ngarkuara mbi mjetet pensionale

Buxheti i FKPK-së miratohet nga Bordi bazuar në rekomandimet e Komisionit për Buxhet.

FKPK-ja financohet në mënyrë të ngjashme sikurse të gjitha fondet pensionale me kontribut të definuar, d.m.th. duke ngarkuar tarifa mbi mjetet nën menaxhim (mjetet pensionale).

Si një institucion jo-për-profit, tarifat e ngarkuara nga FKPK-ja duhet t'i mbulojnë vetëm shpenzimet e saj. Nivelet e tarifave, sipas rekomandimeve të Bordit, miratohen nga Kuvendi; duke i siguruar kështu Kuvendit një shkallë të tërthortë të kontrollit mbi shpenzimet e FKPK-së.

Ligji Nr. 04/L-168 i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet pensionale në Kosovë, ka përfshirë vetëm ndryshime lidhur me tarifat e FKPK-së dhe trajtimin e tyre. Me këtë amendamentim, një tarifë menaxhuese që përdorej për t'i mbuluar edhe shpenzimet investuese edhe ato operacionale të FKPK-së është ndarë në dy: tarifën investuese, e cila do të mbulojë shpenzimet që lidhen me investimin e mjeteve pensionale; dhe tarifën operacionale, e cila do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet e tjera.

Kryesisht për shkak të vonesës së miratimit të Ligjit Nr. 04/L-168, FKPK-ja në gjysmën e parë të vitit ka ngarkuar tarifën vjetore menaxhuese prej 0.60%, e cila ishte miratuar nga Kuvendi për vitin 2012.


Nga 20 maji 2013 – kur Kuvendi i miratoi tarifat sipas ligjit të amendamentuar – e deri në fund

të 2013-s, FKPK-ja ka ngarkuar gjithsej tarifa prej 0.53% vjetore. Tarifa totale përbëhej nga tarifa për investime prej 0.38% vjetore, dhe tarifa operacionale prej 0.15% vjetore.

Tarifat e FKPK-së prej 0.53% vjetore, vazhdojnë të jenë më të ulëta krahasuar me të gjithë operatorët e ngjashëm në rajon. Në Kroaci mesatarja e tarifave menaxhuese e ngarkuar nga operatorët pensionalë ishte 0.45% për vit, në Maqedoni ishte 0.54%, në Rumani 0.60%, dhe në Bulgari 1.00% në vit.

Edhe pse në pamje të parë tarifat menaxhuese të ngarkuara nga operatorët pensionalë në Kroaci duken më të ulëta sesa ato të FKPK-së, duhet pasur parasysh se operatorët kroatë ngarkojnë edhe tarifa prej 0.5% deri 0.8% për çdo kontribut të arkëtuar (ndryshe: tarifë hyrëse), duke i bërë kështu ata më të shtrenjtë sesa FKPK-ja për kontributet e reja.

Çka është edhe më e rëndësishme, operatorët pensionalë në Kroaci me tarifat menaxhuese mbulojnë vetëm shpenzimet operacionale (tarifa ekuivalente e FKPK-së për të cilën është 0.15% vjetore), meqë shpenzimet që lidhen me investimin e mjeteve trajtohen si shpenzime të fondit dhe jo shpenzime të operatorit. Të gjithë operatorët në vendet e tjera të lartpërmendura ngarkojnë tarifa hyrëse, si dhe kontabilizojnë shpenzimet e lidhura me investimin e mjeteve pensionale, në të njëjtën mënyrë sikurse operatorët në Kroaci.




Përkundër uljes në normën e tarifës nga viti në vit, në vlerë nominale tarifat e ngarkuara nga FKPK-ja janë rritur. Në vitin 2013 vlera nominale e tarifave të ngarkuara u rrit për 15% krahasuar me 2012, në €4,599,464. Kjo për shkak se mjetet nën menaxhim ishin rritur ndjeshëm gjatë vitit (23%), e bashkë me to u rritën edhe shpenzimet investuese (18.4%).


Të ardhurat jo-tarifore të FKPK-së, të cilat kryesisht përbëhen nga interesat e depozitave me afat të aseteve operacionale, ishin €314,706 për vitin. Kjo bëri që të hyrat e përgjithshme të operacioneve të FKPK-së për vitin 2013 të jenë €4.9 mln, ose 7% më të larta se një vit më parë (2012: €4.6 mln).

## Shpenzimet

### FKPK-ja ka shpenzime për investimin e mjeteve pensionale dhe për operacionet e saj



30.9%



69.1%

Shpenzimet për investime lidhen me kostot e investimit të mjeteve pensionale në tregjet globale dhe në vend, dhe përbënin 72.5% të shpenzimeve të FKPK-së (2012: 69.1%).

Shpenzimet për investime për 2013-n u rritën për 18.4% në €2,892,868 (2012: €2,442,492). Rritja e mjeteve nën menaxhim, më saktësisht e mjeteve në fondet e hapura, është arsyeja primare për rritjen e shpenzimeve investuese.

Legjislacioni aktual në Kosovë, ndryshe nga legjislacionet e fondeve pensionale në botë, nuk lejon që FKPK-ja ta ushtrojë vet aktivitetin e menaxhuesit të mjeteve, dhe të jetë kështu investitor i drejtpërdrejtë.

Në vend të kësaj FKPK-së i duhet t'i investojë mjetet përmes fondeve të hapura, një opsion që shkakton shpenzime më të mëdha. Andaj nuk është çudi që tarifat e ngarkuara nga menaxherët e fondeve të hapura përbëjnë pjesën dërrmuese të shpenzimeve investuese (98%).

Megjithatë, ka edhe përfitime të vlefshme nga të investuarit përmes fondeve të hapura. Arrihet një diversifikim i gjerë i investimeve pa pasur nevojë të bëhen shpenzime të shumëfishta për transaksione. Përveç kësaj, FKPK-ja përfiton shumë edhe nga ekspertiza e madhe e menaxherëve të këtyre fondeve dhe nga infrastruktura e tyre.

Shpenzimet për operacione përfshijnë të gjitha shpenzimet e tjera të cilat përbëhen prej kompensimeve, shtypjes së pasqyrave të llogarive, qirasë së zyrës, dhe shpenzimeve të tjera për operim. Për vitin 2013 ato arritën në €1,095,474 (2012: €1,089,814) dhe përbënin 27.5% të totalit të shpenzimeve (2012: 30.9%).

Gjersa rritja prej 18.4% e shpenzimeve për investime ishte në përpjestim të drejtë dhe pozitiv me rritjen e mjeteve pensionale, e njëjta nuk mund të thuhet për shpenzimet operacionale, të cilat u rritën për vetëm 0.5% krahasuar me vitin paraprak.

Shpenzimet operacionale kanë qenë pothuajse të njëjta ndërkohë që shërbimet për klientë janë rritur ose përmirësuar. Kjo është arritur përmes rritjes së produktivitetit dhe eficiencës.

Shpenzimet e Bordit kanë rënë me 5.8% dhe përbënin 13.5% të shpenzimeve operacionale (2012: 14.4%). Pagat bazë të stafit kanë rënë me 6.1% dhe përbënin 36.2% të shpenzimeve operacionale (2012: 38.8%). Shtypja e pasqyrave vjetore të llogarive ishte shpenzimi i tretë më i lartë tek operacionet me 10.2% (2012: 9.3%), e ndjekur nga afër nga zhvlerësimi dhe amortizimi prej 9.4% (2012: 6.7%).<sup>1</sup>

	2013		2012	
	Norma vjetore e tarifave	Tarifat e ngarkuara	Norma vjetore e tarifave	Tarifat e ngarkuara
<b>Fondet e hapura</b>				
BNY Mellon – RRF	0.60%–0.70%	€763,930	0.70%	€485,001
Aquila Capital – RP7	0.79%–1.06%	€625,429	0.96%	€633,154
Schroders – ISBF	0.50%	€453,392	0.50%	€312,575
AXA – GILB	0.35%–0.40%	€433,045	0.40%	€385,985
Vanguard – GSIF	0.13%	€396,448	0.15%	€355,924
ECM – DEC	0.50%	€113,244	0.50%	€106,385
State Street – EMEIF	0.20%	€51,450	0.20%	€52,168
BNP Paribas – GLF	-	-	0.20%	€53,264
<b>Totali i tarifave të fondeve të hapura</b>		<b>€2,836,938</b>		<b>€2,384,456</b>
Tarifat e BQK-së për transfere, etj.		€30,422		€31,497
Brokerët, kujdestarët dhe zotimet		€25,508		€26,539
<b>Totali i shpenzimeve investuese</b>		<b>€2,892,868</b>		<b>€2,442,492</b>

Me të hyra të përgjithshme prej €4.9 mln dhe shpenzime prej €4.0 mln, suficiti për vitin ishte €0.9 mln (2012: €1.1 mln). Duhet të theksohet se është e vështirë të parashikohen alokimet strategjike të mjeteve nga Bordi për vitin e ardhshëm. Për shkak të faktorëve të jashtëm, është edhe më e vështirë për të parashikuar performancën e investimeve, e me to edhe mjetet nën menaxhim për vitin e ardhshëm.

Dallimet në të hyrat dhe shpenzimet e ndodhura kundrejt atyre të buxhetuara janë ato që kanë shkaktuar suficitin për vitin, dhe janë rezultat i drejtpërdrejtë i këtyre vështirësive. Në mënyrë që tepriat që ishin akumuluar të zbriten, Bordi vendosi në tetor 2013 për kthimin e €3m në fond (mjeteve pensionale). Rimbursimi u ekzekutua në dhjetor 2013, gjë që e la në €47,380 bilancin e suficitit nga aktivitetet operacionale më 31 dhjetor 2013.

<sup>1</sup> Për më shumë informacione ju lutemi referojuni pasqyrave financiare të audituara, të cilat, sikurse kërkohet me Rregullat Pensionale të BQK-së, përgatiten në pajtueshmëri me SNRF.



“ Nëse gjithmonë bën atë që gjithmonë ke bërë,  
gjithmonë do të marrësh atë që gjithmonë ke marrë. ”

Henry Ford (1863–1947)  
Themeluesi amerikan i Ford Motor Company



## AKTIVITETET

Kjo thënie e famshme e Henry Ford është burimi më i madh i inspirimit për të gjithë në FKPK. Por, gjithmonë të bësh atë që gjithmonë ke bërë nuk është edhe aq keq nëse gjithmonë bën atë që ne gjithmonë kemi bërë, e që është:

### TË PËRMIRËSOHESH!

#### Aktivitetet e Bordit

Viti 2013 ishte vit mjaft i ngarkuar për anëtarët e Bordit. Katër takime të rregullta u mbajtën, mirëpo përgjatë vitit shumë vendime u morën edhe jashtë këtyre takimeve.

Zhvillimi më i rëndësishëm tek investimi i mjeteve pensionale<sup>2</sup> ishte miratimi nga Bordi i Manualit të Investimeve, sikurse ishte rekomanduar nga Komisioni i Investimeve. Manuali përfshinë Deklaratën e re të Parimeve të Investimeve (DPI), Udhëzuesin e Politikave Investuese (UPI), dhe bençmarkun për performancën e investimeve të mjeteve pensionale.

I ndihmuar nga Komisioni i Investimeve dhe Menaxhmenti, Bordi gjithashtu publikoi thirrjen për propozime, me qëllim të angazhimit të fondeve të reja të hapura që do përshtateshin me UPI-n e ri.

Gjithashtu në fushën e investimeve, Bordi gjatë vitit investoi €190 mln ndërkaj tërëhoqi investime në vlerë prej €219 mln si parapërgatitje për investime sipas UPI-t të ri.

Në anën tjetër, Komisioni i Auditimit ishte kryesisht i përfshirë në shqyrtimin e raporteve të auditimit të brendshëm dhe raporteve të inspektimit të BQK-së, dhe në dakordimin e planeve të nevojshme të veprimit.

Komisioni gjithashtu u pajtua me auditorin e brendshëm për planin e auditimit për vitin 2014.

Në muajin prill Bordi ia parashtrroi Kuvendit kërkesën për ndryshimin e tarifave për pjesën e mbetur të 2013-s (shih faqen 12), e në tetor parashtrroi kërkesën për tarifën që do të ngarkohen për vitin 2014.

Përveç këtyre, Komisioni për Buxhet gjithashtu ka rekomanduar, dhe Bordi e mbështeti, që €3 mln të akumuluar nga suficiti i aktiviteteve operacionale t'i kthehen mjeteve pensionale.

Komisioni për Ankesa i ka trajtuar 35 kërkesa nga kontribuuesit dhe institucionet. Shumica e kërkesave ishin nga kontribuuesit që kërkonin tërheqjen e kursimeve para moshës së pensionimit ose tërheqjen e kursimeve në një pagesë të vetme edhe pse i plotësonin kriteret për tërheqjen e kursimeve në faza.

Sikurse edhe ishte rekomanduar nga Komisioni për Ankesa, Bordi i kishte shkruar BQK-së duke kërkuar rishikimin e Rregullave Pensionale për tërheqjen e kursimeve në faza. Përmes kësaj letrë i kërkohej BQK-së për të shqyrtuar mundësitë ligjore për të lejuar që një pjesë modeste të kursimeve t'iu paguhet menjëherë kontribuuesve që pensionohen në skemën e tërheqjes me faza.

<sup>2</sup> Më shumë detaje për të gjitha aspektet e investimit të mjeteve pensionale prezantohen në kapitullin 04/Investimi i kursimeve pensionale.

## Menaxhimi i llogarive

U shtypën 412,623 pasqyra që paraqitin ndalesat individuale

Krahasuar me një vit më parë janë printuar 24,124 më shumë pasqyra të llogarisë. Kontribuuesit për të cilët FKPK-ja nuk kishte adresa ishin 14,133 (2012: 13,299) dhe për ta pasqyrat e llogarisë nuk janë shtypur.

Me qëllim të ngritjes së transparencës së institucionit këtë vit në pasqyra është përfshirë një risi. Tarifat e ngarkuara (në euro) janë përfshirë si pjesë e pasqyrave, duke e informuar çdo llogarimbajtës se sa ka qenë vlera të cilën FKPK-ja ia ka ndaluar. Kjo transparencë është shumë e pazakontë në këtë industri, dhe FKPK-ja është shumë krenare që vullnetarisht e ka marrë këtë iniciativë.

Pasqyrat e llogarisë janë shtypur edhe për 40,580 punëdhënës. Ato i informojnë punëdhënësit për pagesat e kontributeve dhe raportimet që i kanë bërë për to, dhe po ashtu për mosbarazimet eventuale.

FKPK-ja hapi 29,195 llogari të reja individuale (2012: 28,179), duke e çuar numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura qysh prej themelimit në 447,259. Nga llogaritë e reja të hapura gjatë vitit 29,097 ishin për kontribuuesit nismëtarë, d.m.th. që filluan kontribuimin më 2013.

Për shkak të pensionimit (ose vdekjes) të kontribuuesve 3,567 llogari janë shndërruar në llogari të "Tërhequra" gjatë 2013 (2012: 3,264). Numri total i llogarive të tërhequra ka arritur në 20,503. Pasqyrat e llogarive nuk shtypen për këtë kategori të llogarimbajtësve.

Gjatë vitit ishin 21,918 punëdhënës dhe 29,996 të vetëpunësuar që kishin paguar kontribute (2012: 20,756 dhe 30,538, respektivisht). Përveç kësaj ishin 1,255 punëdhënës dhe 4,873 të vetëpunësuar që kanë paguar kontribute vetëm për vitet paraprake (2012: 1,377 dhe 2,053, respektivisht).

FKPK-ja i ka trajtuar dhe procesuar gjatë vitit 316,242 raporte të kontributeve (2012: 183,604). Arsyeya kryesore për rritjen prej 72% në numrin e raporteve është për shkak se nga tetori i 2012-s raportimi mujor u bë i detyrueshëm. Para kësaj punëdhënësit e kishin opsionin e raportimit në baza tremujore.

Përkundër kësaj rritjeje, raportet korrigjuese përbënë 5.5% të të gjitha raporteve (2012: 6.0%). Është e qartë se raportimi i detyrueshëm mujor i ka përmirësuar që të dyja, shpejtësinë dhe saktësinë e raportimit nga punëdhënësit.

Udhëzimi i ri Administrativ për raportimin dhe pagesën e kontributeve pensionale u lëshua nga ATK-ja në shtator të 2013-s, dhe FKPK-ja i përshtati proceset e saj të brendshme sipas këtij udhëzimi. Udhëzimi e ndalon debitimin e kontributeve në llogaritë individuale të kursimeve pensionale pa miratimin paraprak nga inspektori i ATK-së. Kjo me qëllim që punëdhënësit, ose përfaqësuesit e tyre, të jenë më objektiv në raportimin e kontributeve.

Në total ishin 2.86 mln transaksione të postuara në llogaritë e kontribuuesve dhe 410 mijë në llogari të punëdhënësve (2012: 2.58 mln, respektivisht 402 mijë).

Të përfshira në transaksionet e llogarive të punëdhënësve janë 17,390 transaksione për refondim të kontributeve të gabuara, 76% e të cilave ishin paguar gjatë 2013. Më 2012 vetëm 13% e transaksioneve të refunduara ishin paguar gjatë atij viti. Qasja proaktive e përvetësuar nga FKPK-ja për identifikimin e kontributeve të gabuara ka rezultuar në identifikimin dhe më pas refondimin e tyre më të mirë, më të shpejtë dhe më të besueshëm.



**9.6** – Numri mesatar i muajve për të cilët punëdhënësit kanë paguar kontribute

**3.4** – Numri mesatar i tremujorëve për të cilët të vetëpunësuarit kanë paguar kontribute

## Barazimi

Pagesat e të vetëpunësuarve të barazuara 100%

Prej 2011-s, kur FKPK-ja filloi së shfrytëzuar Sistemin Ndërbankar të Kliringut (SNK), procesimi i kontributeve të paguara në llogari të punëdhënësve është përmirësuar jashtëzakonisht shumë. Gjatë 2013-s ky proces është monitoruar në baza ditore, dhe çfarëdo pagese e pabarazuar është trajtuar menjëherë.

Kontributet e të vetëpunësuarve ishin veçanërisht keq sa i përket barazimit para përdorimit të SNK-së; por gjatë 2013 kontributet e të vetëpunësuarve për të dytin vit radhazi u barazuan 100%. Pagesat e punëdhënësve janë alokuar 99.99% në llogaritë e tyre respektive (ose janë refonduar). Gjithsej njëzet pagesa që ishin të pa-alokuara, e që vlenin sa 0.02% e kontributeve të arkëtuara, prisnin kërkesën formale për refondim nga bankat komerciale.

Më 2012 afër 2.9%, dhe më 2011 afër 3.5%, e kontributeve të arkëtuara gjatë vitit, nuk ishin alokuar në fund të viteve përkatëse. Viti 2013 ishte viti i parë kur raportimi obligativ mujor ishte në fuqi gjatë gjithë vitit; dhe rezultatet flasin. Vetëm 0.48% e kontributeve të arkëtuara gjatë vitit nuk ishin alokuar në llogaritë individuale në


fund të vitit, duke tejkuluar kështu objektivin prej maksimumi 2.0% të vendosur nga Bordi.

Me 1.52% në fund të vitit (2012: 2.42%), Administrata e ka tejkuluar dukshëm edhe objektivin tjetër të vendosur nga Bordi për maksimumi 1.85% të kontributeve totale të jenë të pa-alokuara. Këto të fundit në fund të 2013-s kapnin shumën €12.8 mln (2012: €17.5 mln).


Arsyet për mos-alokimin e fondeve ishin: mos-dorëzim i raporteve të kontributeve me €11.3 mln; punëdhënësi që ka bërë pagesën nuk dihet €1.0 mln; dhe, detajet e kontribuuesit jo-valide (ID/Emri) në vlerë €0.5 mln (2012: €15.5 mln; €1.5 mln; dhe €0.5 mln, respektivisht).

Stafi për Marrëdhënie me Klientë i FKPK-së ka luajtur rolin kyç në sigurimin e raporteve të kontributeve të cilat nuk ishin dorëzuar nga punëdhënësit (për vitet paraprake). Gjatë vitit u kontaktuan direkt 1,902 punëdhënës për të siguruar informacionet e munguara. Përkushtimi i stafit në këtë drejtim ka ndihmuar në alokimin e shumicës së €4.6 mln që nuk ishin të alokuara në vitin 2012 por që u alokuan gjatë vitit 2013.

Kontributet kumulative të alokuara dhe të arkëtuara



Kontributet e pa-alokuara: Rezultatet kundrejt objektivave



## Shërbimet për klientë

198 shërbime të ofruara në ditë

Totali i numrit të shërbimeve të ofruara gjatë 2013-s për individë dhe punëdhënës ishte 49,486. Kjo shënon një rritje prej 17% krahasuar me 42,189 shërbimet e ofruara gjatë 2012-s.

Në mesatare 198 shërbime dhe konsultime janë ofruar për çdo ditë pune.

Shumica e shërbimeve (39,839) u ofruan për klientët që vizituan zyrën e FKPK-së, ndërsa pjesa tjetër e shërbimeve u ofruan me e-mail, telefon, ose forma të tjera të komunikimit dhe korrespondencës.

Numri i pasqyrave të llogarive të shtypura (falas) për kontribuuesit vizitorë ishte 31,050. Me 63%, ky njëherësh është shërbimi dukshëm më i popullarizuar i ofruar nga FKPK-ja. Vizitat janë rritur kryesisht falë ambasadave të huaja të cilat i konsiderojnë pasqyrat e llogarive të FKPK-së si dëshmi të punësimit; dhe e kërkojnë pasqyrën si pjesë e dokumentacionit standard që aplikuesit për viza duhet t'i dorëzojnë.

Një numër i kufizuar i shërbimeve të FKPK-së gjithashtu ofrohet në zyrat rajonale të ATK-së përmes Zyrtarëve Pensionalë të ATK-së. Shërbimet e ofruara nga ta, e që përbëheshin kryesisht nga shtypja e pasqyrave të llogarive, numëruan 24,740 sosh.

Shërbimet e tjera kryesore të ofruara nga stafi i FKPK-së ishin: 5,467 autorizime të kërkesave

për qasje në portalin eTrusti; 4,994 adresa të përditësuara; 3,567 aplikacione për pension të trajtuara; dhe 1,119 pyetje të klientëve të përgjigjura.

Popullariteti i portalit eTrusti është rritur, dhe objektivi është që FKPK-ja të ketë gjithnjë e më shumë kontribuues që i qasen llogarisë së tyre nga interneti.

Vetëm 50% e personave që regjistroheshin për qasje i dërgonin në FKPK dokumentet e kërkuara për verifikim të identitetit. Në tentim për ta zgjidhur këtë, FKPK-ja gjatë 2013-s ka filluar të dërgojë e-mail rikujtues tek kjo kategori, nga të cilat, 14% të rasteve janë përmbyllur me rezultatin e dëshiruar.

Shërbimet e ofruara në këtë portal janë të shumta. Përdoruesit e eTrusti-t mund të kontrollojnë bilancin e llogarisë së tyre dhe transaksionet, dhe ndryshe nga shërbimet tipike të e-banking, këto transaksione nuk kufizohen në 3-6 muajt e fundit.

Përditësimet që janë bërë përmes portalit, e që ishin gjithsej 5,631, përbëheshin nga: 2,140 adresa; 1,491 përcaktime të trashëgimtarëve; 1,370 numra të telefonit; 354 adresa të e-mailit; gjersa shërbimi i sapo ofruar më 2013 për aplikimin për pension përmes internetit është kompletuar 6 herë.

Gjithsej numri i shërbimeve të ofruara nga zyra për individët dhe punëdhënësit

2012	2013
42,189	49,486

17%

## INVESTIMI I KURSIMEVE PENSIONALE

Siguria e kursimeve pensionale; diversiteti i investimeve; maksimizimi i kthimit për nivelin e ndërmarrë të riskut, dhe mirëmbajtja e likuiditetit adekuat; janë në bërthamën e parimeve të matura investuese të FKPK-së

Për një fond të cilit në pesë vjetët e fundit i janë rritur mjetet nën menaxhim mesatarisht për 29% në vit, sfidat për ide dhe mundësi të reja investuese rriten eksponencialisht, dhe bashkë me to rriten edhe përgjegjësitë.

Bordi, dhe veçanërisht Komisioni për Investime, janë dashur të ballafaqohen me këto përgjegjësi.

Viti 2013 ishte i fokusuar në konstituimim e një pakoje të politikave dhe parimeve investuese që do të synonin t'i bënin investimet e FKPK-së më pak të ndjeshme ndaj kushteve gjithnjë e më të ndryshueshme dhe jo-stabile në tregje.

## Parimet dhe politika e investimeve

Kalimi në një mik të klasave të aseteve dhe strategjive investuese

Në fillim të vitit 2013 Politika Investuese e FKPK-së ishte që t'i investojë deri në 40% të mjeteve në fonde të indeksuara të aksioneve dhe 60% në fonde të hapura me bono dhe kthim absolut.

Politika e mësipërme është dëshmuar si shumë e suksesshme meqë rritja e çmimit të aksionit ishte 40.8% qysh prej përvetësimit të saj më 2009. Megjithatë, në një botë përplot pasiguri nga niveli i lartë i borxheve nacionale, rritjes së ngadalhtë dhe inflacionit të ulët, dhe bashkë me këto ngadalësimit të rritjes së tregjeve në zhvillim, Bordi e ka pranuar nevojën për të evoluar, dhe ka vendosur parime dhe politika të reja investuese, që pritet të shërbejnë së paku pesë vjetët e ardhshëm.

Duke qenë se objektivi kryesor i investimeve të FKPK-së në afatgjatë është që, së pari të ruajë dhe së dyti të rrisë kapitalin e kontribuuesve, në terma nominalë dhe ata realë, Deklarata e re e Parimeve Investuese të Bordit e ka vendosur Indeksën e Çmimeve të Konsumit të Kosovës si benchmark kundrejt të cilit do të matet performanca e investimeve të FKPK-së.

Udhëzuesi i ri i Politikave Investuese (UPI) e njeh faktin se asnjë portofolio investuese nuk mund të arrijë kthim pa ndërmarrë një dozë të caktuar të riskut të tregut (financiar), dhe se asnjë portofol nuk mund të izolohet plotësisht ose pjesërisht nga risqet e tregut.

UPI-ja e re, duke e pranuar që duhet të ketë një ekuilibër mes kontribuuesve që janë afër pensionimit dhe atyre që nuk janë, bën thirrje

Limitet e alokimit sipas klasave të aseteve	
Puro aksione	55%
Multi-asete	40%
Puro instrumente borxhi	30%
Tregu i parasë dhe Thesari i Kosovës	10%

Bordi duhet patjetër që t'i marrë të gjitha vendimet për alokimin strategjik brenda kornizës së re. Për më shumë, vendimet për të ulur ose shtuar ekspozimin ndaj një fondi të hapur patjetër duhet të varen nga: a) vlerësimet e Bordit për pritjet në afatshkurtër dhe afatmesëm për klasën e aseteve si dhe për qasjen investuese të fondit në fjalë; dhe b) performancën dhe luhatshmërinë e fondit, plasmaneve të tij dhe korrelacionin me fondet e tjera në portofol.

për një politikë e cila përmbanë një masë të arsyeshme por jo të tepruar të alokimit në mjete afatgjata nga të cilat pritet kthim dhe luhatshmëri me e lartë, të tilla si aksionet; e kombinuar me një alokim më të madh në investime nga të cilat pritet luhatshmëri më e vogël dhe kthime më stabile sesa tek aksionet.

UPI-ja e përcakton diversifikimin e investimeve si mjetin kryesor për të zbutur riskun e tregut. Më tej e njëjta bën thirrje për përdorim të instrumenteve të kthimit absolut me strategji të risk-menaxhimit dhe risk-targetimit, e të cilat nuk kanë korrelacion me ndonjë klasë ose treg financiar të caktuar (p.sh. bonot, aksionet, ose valutat, për t'i përmendur disa), dhe në të njëjtën kohë duke tentuar të ketë korrelacion të ulët edhe në mes të investimeve të tjera të bëra; për të ndihmuar kështu në amortizimin e lëvizjeve ekstreme në çmimet e tregut, në kërkim të luhatshmërisë më të ulët për investimet e FKPK-së, përkatësisht, në kërkim të kthimeve më stabile.

Me këtë theks të rritur ndaj riskut, objektivi i UPI-t është të ofrojë më shumë mbrojtje kur tregjet janë në rënie, por megjithatë për t'i korrë shpërblimet kur tregjet rriten.

Për këtë qëllim UPI qenësisht ka vendosur një kornizë të re për limitet e alokimit të mjeteve (shih grafikun më poshtë) të bazuar në një mik të klasave të aseteve dhe strategjive të investimeve (qasjeve) që menaxherët e fondeve i aplikojnë.

Limitet e alokimit sipas qasjes investuese	
55%	Me synim kthimin Pa konsiderim riskun
40%	Me risk të targetuar/menaxhuar ose Kthim absolut
30%	Me fokus të hyrat

Një thirrje për oferta është publikuar në nëntor, proces i cili ende nuk ka përfunduar, me qëllim të angazhimit të fondeve të reja të cilat do të përshtaten me kornizën e re. Fondet e kërkuara ishin:

- fonde të aksioneve me qasje ndaj atyre që ofrojnë dividend;
- fonde të asioneve me targetim/menaxhim të riskut ose me kthim absolut;
- fonde me multi-asete me targetim/menaxhim të riskut ose me kthim absolut.

## Shpërndarja e mjeteve

€52.8 mln u investuan në fletobligacione të Kosovës gjatë vitit 2013

FKPK-ja i investon shumicën e mjeteve përmes fondeve të hapura, të cilat menaxhohen nga kompani të specializuara që operojnë në tregjet globale financiare.

Bordi kërkon që këto instrumente të jenë likuide dhe të mirë-divesifikuara, të kenë performancë të kënaqshme, që investimet e tyre të jenë në pajtim me Ligjin për Fondet pensionale të Kosovës si edhe me politikën investuese të FKPK-së, dhe që menaxherët e fondeve të kenë përvojë të mjaftueshme në industri.

Prej janarit e deri në përvetësimin e UPI-t të ri Bordi i ka investuar €137 mln shtesë në tregjet globale financiare përmes fondeve të hapura të menaxherëve në vijim: BNY Mellon €45 mln, Vanguard €42 mln, Schroders €30 mln, dhe nga €10 mln me të AXA-s dhe Aquila-s.

Në Kosovë Bordi i investoi edhe €52.80 mln. në fletobligacione 6-12 mujore, duke e konfirmuar qëllimin e tij të plotë për të luajtur një rol aktiv në konsolidimin e tregjeve publike në vend për instrumente financiare. Që ty dyja investimet e bëra më 2012 në fletobligacione të Qeverisë së Kosovës, maturuan me vlerë prej €13.96 mln.

Afatizimet me Raiffeisen Bank Kosovo që vlenin €16.20 mln u ndërprejnë para kohe nga banka për shkak të likuiditetit të saj të tepërt; gjersa depozitat në NLB Prishtina, që vlenin €16.60 mln, nuk u ridedepozituan për shkak se u zëvendësuan me investime në fletobligacione të Kosovës, të cilat ofronin një alternativë më të matur investuese.

Investimi	Klasa e mjeteve	Mjetet	Alokimi
Vanguard – Global Stock Index Fund	Aksione	€313.4 mln	44.5%
BNY Mellon – Real Return Fund	Multi-asete	€133. mln	18.9%
Schroders – International Strategic Bond Fund	Bono	€96.4 mln	13.7%
AXA – Global Inflation Linked Bonds Fund	Bono	€57.5 mln	8.2%
Thesari i Kosovës	Bono thesari	€53.1 mln	7.5%
Aquila – Risk Parity 7 Fund	Multi-asete	€27.0 mln	3.8%
ECM – Diversified European Credit	Bono	€23.4 mln	3.4%
<b>Total i mjeteve të investuara</b>		<b>€703.9 mln</b>	<b>100.0%</b>

## Por, ku janë paratë?

Paratë e investuara përmes fondeve të hapura investohen nga menaxherët e këtyre fondeve në aksione, instrumente borxhi, para të gatshme dhe në instrumente të tjera financiare të korporatave botërore dhe të shteteve sovraane.

Me adoptimin e UPI-t në tetor 2013, Bordi duhej të ndërmerre vendime strategjike të alokimit me qëllim që kjo e fundit t'i përshtatej kornizës së re, dhe kështu u vendos të tërhiqen €219 mln nga fondet e hapura për arsytet e mëposhtme:

- Tërheqjen e plotë nga fondi State Street Emerging Markets Equity Index Fund ku ishin €32 mln, për shkak se pritjet për këtë klasë asetesh në afatshkurtër dhe afatmesëm u vlerësuan të ulëta;
- Të tërhiqen €75 mln nga fondi i indeksuar i Vanguard; për të qenë në linjë me kornizën e re investuese e cila bën thirrje për diversifikimin e investimeve në aksione në mes të fondeve të indeksuara dhe atyre të menaxhuara aktivisht;
- Të tërhiqen €60 mln nga AXA për shkak se të gjithë treguesit ishin se inflacioni i ulët do të zgjasë më shumë sesa ishte menduar më parë, duke e bërë këtë produkt më pak atraktiv tani-për-tani; dhe
- Të tërhiqen €52 mln nga Aquila për shkak se qasja e saj me targetim riskun doli të jetë në korrelacion më të lartë me fondet e tjera në portofol sesa mendohej.

Tërheqjet e mësipërme realizuan fitime neto prej €19.4 mln, por nga ana tjetër ndikuan që bilanci në BQK në fund të vitit të jetë €209.65 mln.

Viti 2013 për FKPK-në u mbyll me mjete në vlerë prej €703.9 mln të investuara në tregjet financiare, nga të cilat €53.1 mln në Kosovë dhe €650.8 mln globalisht.

# POR KU JANË PARATË?



Shteti	Alokimi	Vlera
01 SHBA	34.97%	€246,173,248
02 Mbretëri e Bashkuar	14.27%	€100,454,454
03 Kosovë	7.55%	€53,122,905
04 Gjermani	6.47%	€45,571,659
05 Francë	5.96%	€41,955,749
06 Japoni	4.27%	€30,058,901
07 Austri	3.84%	€27,031,892
08 Zvicër	3.67%	€25,835,168
09 Holandë	3.56%	€25,060,817
10 Kanada	2.69%	€18,936,404
11 Australi	2.52%	€17,739,679
12 Suedi	1.73%	€12,178,431
13 Spanjë	1.57%	€11,052,102
14 Itali	1.39%	€9,784,982
15 Luksemburg	1.42%	€9,996,168
16 Norvegji	0.82%	€5,772,435
17 Irlandë	0.74%	€5,209,271
18 Zelandë e Re	0.45%	€3,167,800
19 Danimarkë	0.35%	€2,463,844
20 Belgjikë	0.27%	€1,900,680
21 Finlandë	0.18%	€1,267,120
22 Afrikë e Jugut	0.12%	€848,266
23 Meksikë	0.12%	€841,227
24 Brazil	0.09%	€633,560
25 Filipine	0.07%	€492,769
26 Kroaci	0.06%	€422,373
27 Poloni	0.05%	€355,498
28 Qipro	0.05%	€348,458
29 Katar	0.04%	€285,102
30 Portugali	0.04%	€281,582
31 El Salvador	0.04%	€278,062
32 Jo-specifike/Të tjera	0.63%	€4,434,920
<b>Total</b>	<b>100.0%</b>	<b>€703,955,526</b>

Të investuara në të gjithë globin!

## Emetuesi Nr. 1: Thesari i Kosovës

Për herë të parë qysh prej themelimit një emetues kosovar zuri vendin e parë si emetuesi me më së shumti mjete të investuara të FKPK-së në fund të vitit; në të vërtetë emetuesi Nr. 1 ishte Thesari i Kosovës me €53.1 mln, ose 7.55% e mjeteve të investuara (5.81% e gjithsej mjeteve kur përfshihet paraja e gatshme në BQK).

Emetuesi	Mjetet	Përqindja e mjeteve të investuara
01 Thesari i Kosovës	€53.1 mln	7.55%
02 Thesari i SHBA	€38.6 mln	5.49%
03 Thesari i MB	€12.2 mln	1.74%
04 Thesari i Francës	€10.8 mln	1.53%
05 Thesari i Gjermanisë	€9.7 mln	1.37%
06 Microsoft Corp	€8.7 mln	1.24%
07 Thesari i Holandës	€7.8 mln	1.11%
08 HSBC	€6.7 mln	0.95%
09 GlaxoSmithKline	€6.2 mln	0.88%
10 Bayer Ag	€5.7 mln	0.81%

Zakonisht vendi i parë sikur ishte i rezervuar për Thesarin e SHBA-ve, por tërheqja e një pjese të madhe të investimeve nga fondi AXA GILB e vendosi Thesarin e SHBA-ve në vendin e dytë. Top 20 emetuesit e mëposhtëm përbënin 29% të mjeteve të investuara të FKPK-së. Pjesa tjetër prej 1,811 emetuesve, me ekspozim prej 0.5% ose më pak secili, ndanin 71 përqindëshin tjetër.

Emetuesi	Mjetet	Përqindja e mjeteve të investuara
11 Vodafone Group	€5.3 mln	0.75%
12 Thesari i Italisë	€5.0 mln	0.71%
13 Novartis Ag	€5.0 mln	0.70%
14 Apple Inc	€4.9 mln	0.70%
15 Total S.A	€4.9 mln	0.69%
16 Roche Hldg Ag	€4.8 mln	0.68%
17 Exxon Mobil Corp	€4.3 mln	0.61%
18 Thesari i Norvegjisë	€4.3 mln	0.61%
19 Sanofi-Aventis	€4.1 mln	0.58%
20 Citigroup Inc	€3.9 mln	0.55%

## Investimet përbënin 57.4% të mjeteve të investuara


Analiza e FKPK-së (që është burim i të gjitha statistikave në këtë kapitull), për investimet direkte dhe plasmanet indirekte përmes fondeve të hapura, nxorri në pah se në fund të vitit mjetet ishin të investuara në instrumente financiare me valutë: USD 37.1%, EUR 29.1%, GBP 15.8% dhe të tjera 18.0% (kryesisht në CAD, AUD dhe JPY).

Meqë fondet e hapura në portofol që të gjitha ofrojnë mbrojtje për Euro për pjesët e portofolios së tyre që nuk janë në Euro, risku monetar ishte i menaxhuar dhe indirekt.

Më tej, mjetet e investuara të FKPK-së përbëheshin 57.4% prej aksioneve, 40.4% prej instrumenteve të borxhit, 0.4% nga paraja e gatshme, dhe neto 1.8% nga derivatet.


Borxhet shtetërore përbënin 55.1% të instrumenteve të borxhit, gjersa korporatat dhe agjencitë e tjera qeveritare përbënin pjesën tjetër prej 44.9%. Interesi mesatar për këto instrumente të borxhit ishte 2.13%, ku 61% e tyre kishin normë fikse të interesit dhe 39% të ndryshueshme. Nga to, 33% do të maturonin brenda 12 muajve në vijim.

Përqindja e instrumenteve të borxhit (direkte dhe indirekte) sipas rangut të rejtingut të tyre



1. Rejtingu sipas Standard & Poor's, Moody's ose Fitch;
2. Sa më i lartë rangi aq më i ulët risku për humbje në kapital dhe/ose interesa;
3. Legjislacioni e trajton borxhin e Thesarit të Kosovës si 'Të dorës së parë'; por, meqë ende nuk kanë rejting, ato janë prezantuar ndaras nga pjesa tjetër e rangut 'Të dorës së parë'.

Çmimi i aksionit të FKPK-së prej themelimit



## Performanca e investimeve

Është përfituar prej ekspozimit ndaj aksioneve në vendet e zhvilluara

Në një vit i cili ishte shumë i mirë për aksionet me të gjitha indekset kryesore duke arritur vlerat më të larta historike; vit mjaft i vështirë për bonot performanca e të cilave u tejkalua nga aksionet me diferencën më të lartë në 50 vjetët e fundit; ndërkohë që ishte një vit i përforcimit të ekonomisë dhe uljes së papunësisë në SHBA; çmimi i aksionit i FKPK-së u rrit për 8.5% në €1.2117 (2012: u rrit 8.0% në €1.1170).

Krahasuar me fondet pensionale në rajon FKPK-ja ia doli mjaft mirë. Ajo u kalua vetëm nga fondet në Rumani, të cilat kishin kthim mesatar prej 11.7%. Fondet në Maqedoni kishin kthim mesatarisht 8.3%, gjersa ato në Bullgari dhe Kroaci kishin kthime respektivisht 4.7% dhe 4.5%.

Instrumentet e borxhit të cilat, pa përfshirë fletobligacionet e Kosovës, përbënin mesatarisht 41.6% të mjeteve gjatë vitit, kryesisht vuajtën. Vlera e investimeve përmes AXA-s dhe Aquila-s ra për €12.6 mln, ndërsa investimet përmes Schroders dhe ECM ishin më mirë falë përdorimit të derivateve që baraspeshuan mungesën e oportuniteteve në këtë treg.


FKPK-ja përfitoi nga ekspozimi ndaj aksioneve, të cilat mesatarisht përbënë 50.1% të mjeteve gjatë vitit. Më konkretisht u përfitua prej ekspozimit ndaj aksioneve në vendet e zhvilluara; 73.9 mln nga fondi me puro aksione i Vanguard – shtytësi kryesor i fitimeve – dhe në një shkallë më të ulët përmes fondit multi-asetësh të BNY Mellon që ktheu €4.2 mln.

Totali i kthimeve për vitin nga investimet në Kosovë, të cilat përbënë mesatarisht 3.2% të mjeteve, ishte €0.6 mln. Nga ana tjetër totali i parasë së gatshme në BQK, e cila nga mesi i vitit 2012 nuk paguan interes, përbëri mesatarisht 5.1% të mjeteve.

Totali i kthimit nga investimet për vitin arriti në €68.1 mln. Kësaj shume iu shtuan edhe €3 mln të cilat u kthyen në fond nga suficiti i akumuluar prej operacioneve, duke e çuar kështu totalin e të hyrave bruto në €71.1 mln. Kthimi neto, pas zbritjes së tarifave të ngarkuara mbi fondin, rezultoi në €66.5 mln (2012: €50.2 mln).

Investimi	Kthimi bruto	Alokimi mesatar
Vanguard – GSIF	€73.9 mln	36.9%
BNY Mellon – RRF	€4.2 mln	14.8%
Schroders – ISBF	€1.6 mln	10.9%
ECM – DEC	€1.4 mln	2.7%
Fletobligacione të Kosovës	€0.3 mln	2.1%
NLB Prishtina	€0.2 mln	0.6%
Raiffeisen Bank Kosovo	€0.1 mln	0.5%
State Street – EMEIF	-€0.9 mln	3.2%
Aquila – RP7	-€5.0 mln	8.7%
AXA – GILB	-€7.7 mln	14.5%
<b>Gjithsej</b>	<b>€68.1 mln</b>	<b>94.9%</b>

**14%** e personave që kontribuan për herë të parë i kishin 40 vjet e më shumë. A ishte kjo me të vërtetë puna e tyre e parë në këto 12 vjet, apo ata thjesht e lanë ekonominë gri?



## KONTRIBUTET DHE PENSIONIMET

Kontributet e arkëtuara vjetore u rritën për 5.4%.  
Norma e rritjes së pagesave të benefiteve ishte 23.8%.

### Fillimi dhe pasivizimi i kontribuimit

Kontribuuesit nismëtarë: 10.4% e kontribuuesve aktivë

Kur 14% e kontribuuesve aktivë për “herë të parë” gjetën punë<sup>3</sup> në moshën 40 vjeçare ose më të vjetër, pa marrë parasysh se cila do të ishte përgjigja e saktë për pyetjen, kjo mund të merret vetëm si një gjë e mirë.

Nëse njerëzit po dalin nga ekonomia gri dhe po hyjnë në atë formale, atëherë kjo është një gjë e mirë si për ta ashtu edhe për grumbulluesin e taksave. Në anën tjetër, nëse njerëzit e moshës 40+ duke mos qenë të punësuar më parë, ende po gjejnë mundësi për punësim, atëherë kjo iu shkon për shtati atyre që argumentojnë se diskriminimi ndaj moshës në Kosovë është i ulët.

Kjo statistikë është edhe më mbresëlënëse kur merret parasysh fakti se personat e të njëjtës grup-moshë por me më shumë përvojë, përbënin 24% të personave që ri-kontribuan (personat që janë rikthyer në tregun e punës pas pauzimit së paku një-vjeçar).

Një në dhjetë persona që kontribuan për herë të parë, sikurse edhe më 2012, ishin të vetëpunësuar. Femrat po zënë gjithnjë e më shumë pjesë tek kontribuuesit nismëtarë me 36.1% të të punësuarve dhe 21.8% të vetëpunësuarve (2012: 32.8% dhe 20.5%, respektivisht); që nënkupton se gjithnjë e më shumë mundësi po iu ofrohen femrave në Kosovë ose që ato po kalojnë në ekonominë formale me norma pak më të larta sesa meshkujt.

Më së shpeshti kontribuuesit nismëtarë ishin 21 vjeç kur formalisht hynë në tregun e punës, moshë e tyre mesatare ishte 28, gjersa 50% e tyre ishin 25 vjeç ose më të rinj (2012: 21, 29 dhe 23, respektivisht).

Të vetëpunësuarit, sikurse edhe pritet, ishin në mesatare më të moshuar. Sikurse më 2012, më së shpeshti ishin 31 vjeç, moshë e tyre mesatare ishte 35, dhe 50% e tyre ishin 33 vjeç ose më të rinj.

Kontribuuesit nismëtarë numëruan gjithsej 29,097 persona, ndërsa ishin 32,354 të tjerë, ose 12%, të cilët kontribuan më 2012 por jo më 2013; dhe në këtë numër nuk janë përfshirë 3,264 kontribuues nga llogaritë e të cilëve u tërhoqën kursimet gjatë vitit 2012.

Femrat po pasivizohen në norma më të ulëta sesa që po nisin të kontribuojnë, duke përbërë kështu 26.7% nga të punësuarit dhe 16.2% nga të vetëpunësuarit që u pasivizuan.

Pasivizimi më së shumti po ndodh mes moshave 24-26 vjeç. Në fakt, 50% e kontribuuesve të 2012-s që u pasivizuan gjatë vitit ishin 33 vjeç ose më të rinj tek të punësuarit dhe 40 vjeç ose më të rinj tek të vetëpunësuarit (2012: 33 dhe 39, respektivisht). Këto të dhëna nxisin dyshime për një stabilitet më të vogël të punës në moshët më të reja.

Një pozitive ndërkaq është se 15.7% e të punësuarve që kishin kontribuar më parë por që ishin pasivizuar gjatë 2012-s ri-kontribuan më 2013.

Analizimi i të dhënave për 5 vjetet e fundit nxjerr në pah se 146,985 kontribuues të punësuar, dhe 18,495 kontribuues të vetëpunësuar, kanë kontribuar në secilin nga këto 5 vite.

<sup>3</sup> Termi “Punësim” është përdorur në kontekstin më të gjerë të mundshëm. FKPK-ja nuk është në pozitë të dijë nëse kontributet e nismëtarëve janë si pasojë e punësimit të tyre të përhershëm, me afat, apo për një punë të caktuar. Megjithatë, analizat tregojnë se vetëm 52% e kontribuuesve nismëtarë (duke përfshirë këtu të vetëpunësuarit), e përfunduan vitin me kontribute për dhjetor 2013.

## Kontributet

**Nga €844.6 mln kontribute të arkëtuara qysh prej themelimit, €797.7 mln vazhdojnë të jenë nën menaxhim**

Kontributet që nuk janë nën menaxhim, ose €46.9 mln, janë kontribute të tërhequra me rastin e pagesave të benefiteve apo refundimeve, dhe nuk janë më pjesë e fondit.

Kontributet nën menaxhim në fund të vitit përbënë 87.4% të neto mjeteve nën menaxhim (2012: 93.2%). Pjesa e mbetur prej 12.6% përbëhej nga neto fitimet e mbajtura nga investimet (2012: 6.8%).

Totali i kontributeve të arkëtuara gjatë 2013-s ishte €119.1 mln (2012: €113.0 mln), nga të cilat punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit i kanë paguar €107.4 mln për vitin 2013, €9.4 mln për 2012, €1.3 mln për 2011, dhe €1.0 mln për 2002–2010.

Kontributet e paguara për vitin 2012 ishin pak a shumë të pritshme, për shkak se punëdhënësit lejohen që të kryejnë pagesat e kontributeve deri në 15 ditë pas mbarimit të muajit. Megjithatë, ende ka pagesa në shumë jo të vogla që i takojnë periudhave para 2012-s. Këto pagesa zakonisht vijjnë si rezultat i vonësive në pagesë apo edhe rritjes së obligimit të punëdhënësve për kontributet pensionale nga inspektorët e ATK-së.

Kontributet e arkëtuara gjatë 2013-s shënuan një rritje prej 5.4% krahasuar me vitin paraprak (2012: 4.6%). Për vitin e dytë radhazi norma e rritjes nuk ishte dyshifrore sikurse ndodhi në vitet 2003–2011; duke dhënë kështu pak arsye për të besuar se norma e rritjes së kontributeve të arkëtuara do ta përshpejtojë ritmin në vitet në vijim.


Punëdhënësit e rinj që ishin 3,269 pësuan rënie në numër krahasuar me vitin paraprak (2012: 3,363). Punëdhënësit të rinj FKPK-ja i konsideron bizneset, institucionet, etj. të cilat për herë të parë kontribuojnë për punonjës.

Në anën tjetër, numri i punëdhënësve që u pasivizuan ishte 2,900 duke pësuar rritje prej 20% në numër krahasuar me vitin paraprak (2012: 2,417). Punëdhënësit që pasivizohen FKPK-ja i konsideron bizneset, institucionet, etj. të cilat kanë kontribuar për punonjës gjatë vitit paraprak por jo edhe në vitin e raportimit.

Kështu numri i punëdhënësve aktivë, atyre që kontribuan për vitin, u shtua për neto 369 dhe arriti 21,918 (2012: 946 dhe 20,972, respektivisht).

Vitet	Kontributet	
	Të arkëtuara	Nën menaxhim
2002–2010	€504.5 mln	€487.9 mln
2011	€108.0 mln	€99.9 mln
2012	€113.0 mln	€101.9 mln
2013	€119.1 mln	€108.0 mln
<b>Gjithsej</b>	<b>€844.6 mln</b>	<b>€797.7 mln</b>

Përbërja e mjeteve neto nën menaxhim



## Pensionimet dhe pagesat e benefiteve

**Gjatë 2013-s mesatarisht janë realizuar fitime prej 11.1% nga të pensionuarit dhe trashëgimtarët. Më 2012 kjo shifër ishte 3.9%**

Gjatë 2013-s Administrata ka miratuar 3,567 aplikacione të reja për tërheqjen e kursimeve pensionale (2012: 3,264).

Numri i personave që u pensionuan pasi kishin arritur moshën 65 vjeçare të pensionimit ishin 2,676, ose 75.0% e aplikacioneve të miratuara (2012: 2,483, ose 76.1%). Të pensionuar për shkak të invaliditetit ishin 151, që ishin për 57% më shumë se një vit më parë (2012: 96).

Ishin 740 raste në të cilat kursimet u tërhoqën nga trashëgimtarët e kontribuuesve që vdiqën para se t'i tërhiqnin fondet e tyre nga FKPK-ja (2012: 685). Në 40% të rasteve kontribuuesit ishin më të rinj se 55 vjeç kur vdiqën, 23% ishin 55–59, dhe 28% ishin 60–64 vjeç. Duke qenë se 281 prej llogarimbajtësve që vdiqën ishin aktivë gjatë 2013-s, i bie se 1 në 1000 kontribuues aktivë vdiqën para moshës së pensionimit.

Totali i fondeve që u paguan për tërheqjet e kursimeve gjatë vitit 2013 ishte €10.75 mln, e që përbëheshin nga kontributet nominale prej €9.67 mln.

Totali i llogarive me tërheqje prej themelimit arriti në 20,503. Vlera nominale e kontributeve të këtyre llogarive ishte €37.96 mln, ndërsa vlera e tërhequr ishte €38.95 mln.

Nëse një kontribuues që pensionohet ka një bilanc prej €2,000 ose më shumë në llogarinë e tij të kursimeve pensionale, bilanci i llogarisë së

tij transferohet në Programin e Tërheqjes me Faza (PTF); që nënkupton se ata do të marrin një pagesë mujore gjersa e gjithë shumta të shterojë.

Me kërkesë të Bordit dhe miratim të BQK-së, pagesa minimale mujore është ngritur gjatë 2013-s nga €100 në €150, dhe është aplikuar për të gjithë pjesëmarrësit aktual në skemë. Për personat që u pensionuan me bilans mbi €15,000 pagesa mujore ishte 1% e bilansit të tyre.


Shumat e drejtuara në PTF ishin në vlerë €7.90 mln, ndërsa €2.85 mln janë tërhequr nga përfituesit e tjerë me një pagesë të vetme. Transferimi i fondeve në PTF, administrimi i së cilës prej vitit 2011 i është besuar bankës NLB Prishtina, përbënte 73.5% të vlerave të tërhequra për vitin (2012: 67.8%).

Sikurse vazhdojnë të rriten fondet që drejtohen në PTF, edhe numri i të pensionuarve në PTF gjithashtu është rritur në 58.8% për 2013-n (2012: 51.3%); por kjo është edhe e pritshme bazuar në rritjen e bilancit në llogaritë e kontribuuesve, mesatarja e të cilave në fund të vitit 2013 ishte €2,107.

Duhet theksuar se ishin 2,596 kontribuues të cilët deri në fund të 2013-s veçse e kishin arritur moshën e pensionimit por ende nuk kishin aplikuar për tërheqje të fondeve. Bilanci i këtyre llogarive në total ishte €1.3 mln.

Vitet	Tërheqjet	
	Kontribute	Mjete
2004–2010	€14.2 mln	€13.8 mln
2011	€5.7 mln	€5.7 mln
2012	€8.4 mln	€8.7 mln
2013	€9.7 mln	€10.7 mln
<b>Gjithsej</b>	<b>€38.0 mln</b>	<b>€38.9 mln</b>

Përqindja e mjeteve të tërhequra që u drejtuan në PTF





## MOS MERRNI NGA VETJA MË E MOSHUAR!



Filloni kursimin herët!

## KUSH JANË KONTRIBUESIT?

Me raportimin obligativ mujor në fuqi për gjithë vitin 2013, të dhënat në dispozicion kanë qenë më kualitative dhe më të përditësuara sesa në vitet paraprake. Si pasojë, rezultatet e analizave të përfshira në këtë raport vjetor janë më të sakta sesa në vitet paraprake.

Është me rëndësi të theksohet se ky kapitull paraqet rezultatet e analizave vetëm për kontribuuesit aktivë, dhe jo të të gjithë llogarimbajtësve të FKPK-së, e që në fund të vitit ishin 447,259 në numër.

Këtë vit ishin 277,267 kontribuues aktivë (2012: 266,026). Si të punësuar në një vend pune gjatë vitit shfaqen 251,392, dhe si të vetëpunësuar 29,996; në këto shifra të numëruar dy herë janë 4,121 kontribuues të cilët shfaqen gjatë 2013-s edhe si të punësuar edhe si të vetëpunësuar.

Çelësi i kursimit adekuat për pension është kontribuimi i mjaftueshëm dhe i vazhdueshëm. Çereku i të gjitha llogarive tek të gjitha grupmoshat dhe gjinitë kanë kontribute shumë të ulëta dhe/apo sporadike.

Me popullsinë e Kosovës të vlerësuar prej 1.8 milionë banorësh është e vështirë të

besohet se vetëm 15% e popullsisë ishte aktive gjatë vitit. Kjo nxitë dilemën se a kemi të bëjmë me informalitet shumë të lartë apo me besueshmërinë e matjes së papunësisë, apo që të dyja?

FKPK-ja po i thekson analizat e këtylla duke besuar se kështu po e përmbush një pjesë të përgjegjësisë sociale që ka; duke mbajtur këtu në mend se interesi i vetëm i FKPK-së është që secili shtetas i Kosovës të ketë kursyer mjaftueshëm për pensionin e vet.

Duke kuptuar kush, kur, sa dhe sa shpesh kontribuon, mund të ndihmojë në të kuptuarit e arritjeve të deritashme dhe përmirësimeve që duhen bërë në politikat aktuale me qëllim që skema aktuale të bëhet skemë edhe më e mirë. Andaj, me këto në mendje, le t'i takojmë kontribuuesit tanë!

# 277,267 =

Kontribuues aktivë

# 251,392 +

Të punësuar

# 29,996 +

Të vetëpunësuar

# (4,121)

Të dyja, të punësuar dhe të vetëpunësuar

## Si quheni?

Secili prej nesh do ta njohë një Meritë apo një Afërditë, si shoqe, vajzë, nënë, motër, ose kolege. Secili prej nesh do ta njohë një Bekim apo Agim, si shok, djalë, baba, vëlla, ose koleg. Tabelat e mëposhtme listojnë Top 20 emrat më të shpeshtë të femrave dhe meshkujve që kontribuuan gjatë 2013-s.

Përderisa është shumë e qartë se emrat e kontribuuesve nuk kanë ndonjë rëndësi statistikore, megjithatë shërbejnë si një përkujtues për ne në FKPK se prapa numrave janë njerëzit; meqë në FKPK duam të jemi sa më afër gjithsecilit prej jush.


Kontribuues		Kontribuues	
01 Merita	973	Bekim	2,125
02 Afërdita	945	Agim	1,998
03 Shqipe	926	Fatmir	1,866
04 Valbona	911	Arben	1,858
05 Luljeta	871	Afrim	1,834
06 Teuta	857	Naim	1,796
07 Shpresa	847	Besim	1,779
08 Vlora	845	Muhamet	1,707
09 Drita	741	Blerim	1,682
10 Lindita	709	Agron	1,653
11 Vjollca	705	Burim	1,614
12 Mimoza	696	Bajram	1,597
13 Arta	685	Fadil	1,592
14 Fatime	678	Enver	1,577
15 Florije	644	Besnik	1,525
16 Fatmire	622	Avni	1,459
17 Lumnije	610	Driton	1,418
18 Ganimete	560	Bashkim	1,408
19 Blerta	555	Bujar	1,393
20 Emine	554	Ismet	1,383

Variacionet e emrave të njëjtë janë grupuar. P.sh. Merita dhe Meritë janë trajtuar si një emër.

## A jeni mashkull apo femër?

Numri edhe i meshkujve edhe i femrave është rritur krahasuar me vitin 2012. Rritja neto e kontribuuesve ishte 11,241, nga të cilat femra ishin 5,240 ndërkaq meshkuj 6,001.

Përqindja e femrave si pjesë e kontribuuesve aktivë vazhdoi trendin e rritjes së ngadaltë nga viti në vit. Ajo doli të jetë 29.4% duke qenë 28.7% vitin e shkuar. Rritja ishte e ngjashme si për femrat e punësuara ashtu edhe për ato të vetëpunësuara.




## Ku jetoni?

Meqë një pjesë e madhe e kontribuuesve paguhen nga Ministria e Administratës Publike, zyra e së cilës është e regjistruar në Prishtinë, nuk është e mundur të bëhen analiza mbi atë se ku kanë punuar kontribuuesit gjatë vitit. Kjo është arsyeja përse FKPK-ja prezanton vetëm analiza të bazuara sipas komunave të adresave të kontribuuesve që FKPK-ja i ka në regjistrat e saj.

Shumë kontribuues nuk e informojnë FKPK-në kur e ndërrojnë adresën, duke i bërë kështu edhe rezultatet më pak të besueshme.

Vetëm Deçani dhe Leposaviqi kishin më pak kontribuues sesa më 2012, gjersa pesë komunat me rritjen më të madhe në numër të kontribuuesve ishin: Skënderaj 9.2%; Klina 7.6%; Gllgovci 7.6%; Shtërpca 7.4%; dhe Suhareka 7.1%.



Rangu	Komuna	Kontribuues	Pjesëmarrja	Rangu	Komuna	Kontribuues	Pjesëmarrja
01	Prishtinë	53,836	19.4%	20	Klinë	4,594	1.7%
02	Prizren	22,705	8.2%	21	Obiliq	4,403	1.6%
03	Gjilan	16,292	5.9%	22	Deçan	4,142	1.5%
04	Pejë	16,059	5.8%	23	Kaçanik	3,994	1.4%
05	Ferizaj	15,831	5.7%	24	Dragash	3,366	1.2%
06	Gjakovë	15,223	5.5%	25	Shtime	3,344	1.2%
07	Podujevë	12,909	4.7%	26	Graçanicë	1,589	0.6%
08	Mitrovicë e Jugut	12,299	4.4%	27	Shtërpçë	1,143	0.4%
09	Vushtrri	11,653	4.2%	28	Mitrovicë e Veriut	1,140	0.4%
10	Gllgovc	8,876	3.2%	29	Hani i Elezit	1,051	0.4%
11	Lipjan	8,510	3.1%	30	Leposaviq	928	0.3%
12	Suharekë	7,976	2.9%	31	Zubin Potok	687	0.2%
13	Skënderaj	7,265	2.6%	32	Zveçan	599	0.2%
14	Fushë Kosovë	6,437	2.3%	33	Junik	542	0.2%
15	Rahovec	6,193	2.2%	34	Novobërdë	431	0.2%
16	Istog	5,541	2.0%	35	Mamushë	409	0.1%
17	Viti	5,389	1.9%	36	Ranillug	408	0.1%
18	Malishevë	5,207	1.9%	37	Partesh	383	0.1%
19	Kamenicë	5,108	1.8%	38	Klllokot	363	0.1%

## Sa vjeç jeni?

Mosha mesatare e kontribuuesve aktivë në vitin 2013 ka rënë në 40.1 vjeç nga 40.7 sa ishte në vitin paraprak. Mediana mbeti e njëjtë në moshën 38 vjeçare.

Mosha mesatare për kontribuuesit e vetëpunësuar ishte paksa më e lartë me 42.1 vjeç, ndërkaj për kontribuuesit e punësuar ishte 39.5 vjeç.




Mosha mesatare  
**38.7**  
Mediana  
**36**



Mosha mesatare  
**40.7**  
Mediana  
**38**

### Kontribuuesit aktivë sipas grup-moshave



## Për kë punoni?

Numri i kontribuuesve të angazhuar në OJQ u rrit në 13,289 nga 10,958 individë që ishin më 2012 (21.3%). Megjithatë, këta individë janë angazhuar në ekuivalentin e vetëm 5,939 personave me kohë të plotë (EKP). Numri i kontribuuesve në SH.P.K. u rrit për 12.8%; norma e EKP-së e tyre ishte vetëm 65.4%.

Rënia më e madhe këtë vit ishte në ndërmarrjet publike dhe shoqërore, me respektivisht 33.0% dhe 11.3%. Me një normë të EKP-së prej 93.1%, siç mund të pritej, punësimi duket më stabil tek organizatat buxhetore. Ky sektor njëkohësisht pati një rritje më të madhe në numër të kontribuuesve sesa në dy vjetët paraprakë.


Lloji i ndërmarrjes	2012		2013	
	Kontribuues	Kontribuues	EKP	Norma e EKP
01 Organizatë buxhetore	81,927	84,008	78,194	93.1%
02 SH.P.K.	63,698	71,832	46,970	65.4%
03 Biznes individual	61,617	65,683	45,758	69.7%
04 Vetëpunësuar	30,538	29,996	25,497	85.0%
05 Shoqëri aksionare	28,265	28,368	22,430	79.1%
06 OJQ	10,958	13,289	5,939	44.7%
07 Ortakëri	6,379	6,415	4,247	66.2%
08 Ndërmarrje shoqërore	3,012	2,672	2,250	84.2%
09 Ndërmarrje publike	727	487	375	76.9%
10 Të tjera	7,228	7,457	4,973	66.7%

## Kur punoni?


Pas arritjes së nivelit më të ulët në janar, numri i kontribuuesve punëmarrës rritet gjersa arrin pikun, dhe cikli rifillon nga e para. Kjo vlen edhe për kontribuuesit meshkuj edhe për ato femra.

Megjithatë, vet cikli është paksa i ndryshëm për meshkujt dhe femrat. Numri i kontribuuesve punëmarrës meshkuj e arrin pikun në korrik, gjersa numri i femrave në tetor. Për më tepër, oscilimet në numrin e meshkujve janë shumë më të mëdha sesa në rastin e femrave.

Në pikun e tyre (në tetor) 85% e femrave kontribuuese aktive kishin kontribuar; ndërkaj në pikën e tyre më të ulët (në janar) 81% kanë kontribuar. Për meshkujt përqindjet përkatëse ishin 85% dhe 79%.



### Ndryshimi në numrin e kontribuuesve krahasuar me dhjetor 2012



## Sa kontribuoni?

Kontributet mesatare mujore për të punësuarit janë rritur pak krahasuar me 2012. Rritja në mesataren e kontributeve ishte më substanciale tek të vetëpunësuarit (16%), meqë kontributet që duhej lidhur me minimumin e epërm të pagës minimale (€170 për moshat mbi 35 vjeç) ishin më shumë në pajtueshmëri me ligjin gjatë vitit 2013.

Rritja në kontributet mesatare të meshkujve ishte më e lartë sesa tek ajo e femrave. Kjo do të pritej në rast se femrat do të ishin duke u punësuar më shumë në punë që paguajnë më pak ose do të ishin duke përfituar më pak nga rritjet e pagave sesa meshkujt.

Kontributet duket sikur e vërtetojnë teorinë që të ardhurat e punëmarrësve rriten bashkë me moshën e tyre. Në prag të moshës së pensionimit një person mesatarisht është duke kontribuar afro €47 në muaj – që aludon në një pagë mesatare prej €470 për këtë grupmoshë.

Krahasuar me vitin 2012, sikurse ishte rasti për të dy gjinitë, ka rritje të kontributit mesatar mujor për secilën grupmoshë.

Grup-mosha	2013		2012		Ndryshimi
	Të punësuar	Të vetëpunësuar	Të punësuar	Të vetëpunësuar	
	€36.84	€23.66	€36.68	€20.33	0.4%
Gjithsej	€36.11	€36.11	€35.80	€35.80	0.9%
	€39.88	€30.88	€39.38	€26.48	1.3%
Gjithsej	€38.72	€38.72	€38.08	€38.08	1.7%
15-24	€25.10	€25.10	€24.76	€24.76	1.4%
25-34	€37.23	€37.23	€37.09	€37.09	0.4%
35-44	€42.93	€42.93	€42.08	€42.08	2.0%
45-54	€41.73	€41.73	€40.87	€40.87	2.1%
55-64	€43.87	€43.87	€43.63	€43.63	0.6%
65+	€46.94	€46.94	€45.64	€45.64	2.8%

## A jeni duke e paguar minimumin?

Ligji kërkon që, kontributi minimal për të vetëpunësuarit si dhe për të punësuarit me kohë të plotë, të bazohet në pagat minimale mujore të Kosovës e që janë: €130 për personat e moshës deri 35 vjeç; dhe €170 për moshat mbi 35 vjeç.

Krahasuar me vitin e kaluar, përqindja e kontributeve që paguhen nën minimumin e kërkuar me ligj ka rënë nga 10.4% në 6.2% tek të vetëpunësuarit dhe nga 4.5% në 3.7% tek të punësuarit.

Me 57.6% (2012: 53.8%), më shumë se gjysma e të vetëpunësuarve paguan vetëm minimumin e kontributit të kërkuar me ligj; dhe nëse vazhdojnë kështu rrezikojnë të mos kursejnë mjaftueshëm për pensionin e tyre.

Vetëm 4.2% e të punësuarve kanë kontribuar minimumin ligjor (2012: 4.5%); meqë 92.1% e të punësuarve kanë kontribuar mbi minimumin ligjor, mund të argumentohet se pagat minimale mund të rriten pa pasur implikime të mëdha për punëdhënësit.

## Sa duhet të kurseni?

Si shembull, nëse supozohet se çmimi i aksionit të FKPK-së çdo muaj do të rritet me një normë konstante prej 4% në vit, një person i cili punësohet në ditëlindjen e tij të 25-të dhe që kontribuon në minimumin ligjor për 40 vjet deri në pensionim, do të ketë një bilanc të akumuluar në llogarinë e tij në FKPK prej €18,142.

Megjithatë, duke qenë se inflacioni e gërryen vlerën e parasë, nëse inflacioni është p.sh. 2% në vit, vlera e sotme e atij bilanci do të ishte €8,216.

Kjo vlerë, e kursyer përmes kontribuimit minimal, do të ishte e pamjaftueshme për të blerë një anuitet ekonomikisht të favorshëm të jetës. Në rrethanat aktuale një person i tillë do të pensionohej në programin e tërheqjes me faza, të ardhurat mujore nga kursimet pensionale do t'i kishte €150 në muaj për afërsisht 4.5 vjet, pas së cilës periudhë do të mbeste pa të ardhura nga kursimi pensional.

Produkti i anuitetit të jetës nuk ofrohet ende në Kosovë, dhe pa to në treg është e vështirë të përlogaritet bilanci i kursimeve që do të nevojitet për të blerë një anuitet minimal të jetës.

Në anën tjetër, është paksa e vështirë për t'u besuar se kursime më të ulëta se €25,000 (në vlerën e sotme), do të mjaftonin për të blerë një pension minimal.

Me këtë vlerë si qëllim, një person që punësohet në moshën 25 dhe punon deri në pensionim pa pasur asnjë rritje të pagës, duhej kontribuar €41.50 në muaj çdo muaj (punëmarrësi dhe punëdhënësi së bashku). Por nëse i njëjti person çdo vit do të kishte rritje të pagës prej 1%, do të duhej të fillonte me kontribute mujore prej €34.30 dhe të përfundonte me €74.23 në prag të datëlindjes së 65-të. Në rastin e fundit, kontributet mesatare mujore do të ishin €51.74, për afro €10 më shumë se në rastin e parë, gjë që qartëson rëndësinë e kontribuimit sa më të hershëm dhe me shuma sa më të larta të mundshme.

Natyrisht, ekzistojnë sot shumë persona në Kosovë që në vazhdimësi hyjnë e dalin nga puna, ose janë inkuadruar më vonë në skemë dhe kanë më pak vite për të kursyer; për ta do të jetë shumë e vështirë që të sigurojnë pension të mjaftueshëm vetëm përmes kursimeve obligative pensionale.

Stafi i FKPK-së është këtu për të ndihmuar dhe mund ta këshillojë çdokënd që dëshiron të dijë se si dhe sa duhet të kursejnë për një pension më të mirë; ndërkohë që FKPK-ja dhe Bordi i saj do të bëjnë çmos të rrisin vlerën e kursimeve të kontribuuesve me qëllim sigurimin e një pensioni sa më të lumtur të tyre.

## Pjesa tjetër e ekipit



**Botues**

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

**Kryeredaktor**

Vërshim Hatipi

**Autorë**

Vërshim Hatipi

Jeton Demi

**Disajni dhe faqosja**

Nita Xharra

**Fotografitë**

Majlinda Hoxha

**Shtypi**

Studio Forma, Prishtinë

**Tirazhi**

200

**Botuar**

Prill 2014

**Të gjitha të drejtat e rezervuara®**

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kosovski Penzijski Štedni Fond

Kosovo Pension Savings Trust

# FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS OPERACIONET

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2013

**RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR**

Faqet 41-42

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Faqe 43

**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Faqe 44

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË****MJETET NETO TË OPERACIONEVE**

Faqe 45

**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**

Faqe 46

**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE**

Faqet 47-60

## Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC  
Rr. Rexhep Malia 18  
10 000 Prishtina  
Kosovo

T +381 38 247 771  
T +381 38 247 801  
F +381 38 247 802  
[www.grant-thornton.com.mk](http://www.grant-thornton.com.mk)

### Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat e mëposhtme financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës - Operacionet (FKPK-O), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar deri më 31 dhjetor 2013, dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në mjetet neto dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më atë datë, si dhe nga përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël dhe informatave tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen korrekte të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm të tillë që menaxhmenti e përcakton si të nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut për gabimet materiale në pasqyra financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo edhe për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi po ashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që bëhen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën e opinionit tonë të auditimit.

**Opinion**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Operacionet deri më 31 dhjetor 2013, performancën financiare dhe rrjedhjet e parasë për vitin e përfunduar më atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ky raport është përkthim i versionit original në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

*Grant Thornton LLC*  
Prishtinë, Kosovë  
16 prill 2014

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2013 EUR	Më 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Mjetet</b>			
<i>Mjetet qarkulluese</i>			
Paraja në dorë dhe në bankë	4	888,141	736,610
Investimet që mbahen deri në maturim	5	4,000,000	6,000,000
Llogaritë e arkëtueshme	6	350,373	547,927
Shpenzimet e parapaguara		45,151	22,015
		<b>5,283,665</b>	<b>7,306,552</b>
<b>Mjetet joqarkulluese</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	7	159,566	57,805
Mjetet e patrupëzuara	8	233,691	240,597
		<b>393,257</b>	<b>298,402</b>
<b>Gjithsej mjetet</b>		<b>5,676,922</b>	<b>7,604,954</b>
<b>Detyrimet</b>			
<i>Detyrimet afatshkurtër</i>			
Llogaritë e pagueshme		629,542	483,402
		<b>629,542</b>	<b>483,402</b>
Mjetet neto që iu takojnë FKPK- Operacioneve		5,047,380	7,121,552
		<b>5,047,380</b>	<b>7,121,552</b>
<b>Gjithsej detyrime</b>		<b>5,676,922</b>	<b>7,604,954</b>

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së dhe nënshkruar në emër të tyre më 16 prill 2014.






**Dr. Ymer Havolli**  
Kryesuesi i Bordit Drejtues

**Z. Adrian Zalli**  
Drejtori Menaxhues

**Z. Vërshim Hatipi**  
Zëvendës Drejtor – Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Për fund vitin 31 dhjetor 2013 EUR	Për fund vitin 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Të hyrat</b>			
Tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale	10	4,599,464	3,997,932
Të hyrat nga grantet		-	100,280
Të hyrat nga mjetet tjera	11	314,706	491,677
<b>Gjithsej të hyra</b>		<b>4,914,170</b>	<b>4,589,889</b>
<b>Shpenzimet</b>			
<b>Shpenzimet e investimeve</b>			
Tarifat neto të instrumenteve për investime të hapura	12	(2,836,938)	(2,384,456)
Tarifat e BQK-së për transfere dhe mirëmbajtje		(30,422)	(31,497)
Brokerët, kujdestarët dhe shpenzimet për garanci		(25,508)	(26,539)
		<b>(2,892,868)</b>	<b>(2,442,492)</b>
<b>Shpenzimet Administrative</b>			
Shpenzimet për Bordin Drejtues	13	(147,914)	(156,988)
Kostoja e stafit	14	(522,970)	(547,017)
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondenca		(112,094)	(101,252)
Shpenzimet për operim të zyrës		(88,529)	(69,277)
Edukimi publik dhe shpalljet		(19,901)	(32,721)
Mirëmbajtja e softuerit		(36,271)	(24,673)
Tarifa e BQK-së për mbikëqyrje		(15,539)	(22,155)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7-8	(103,319)	(73,279)
Shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët	15	(2,920)	(11,256)
Auditimi i jashtëm		(9,900)	(9,900)
Rimëkëmbja nga fatkeqësitë		(8,616)	(5,777)
Takimet dhe konferencat		(808)	(3,062)
Komunikimi		(8,860)	(8,794)
Tarifat e shërbimeve bankare		(3,982)	(5,242)
Shpenzimet e tjera		(13,851)	(18,421)
		<b>(1,095,474)</b>	<b>(1,089,814)</b>
<b>Gjithsej shpenzime</b>		<b>(3,988,342)</b>	<b>(3,532,306)</b>
<b>Suficiti për vitin</b>		<b>925,828</b>	<b>1,057,583</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënimet	Suficiti EUR	Rezervat EUR	Gjithsej EUR
<b>Më 1 janar 2012</b>		<b>6,063,969</b>	-	<b>6,063,969</b>
Suficiti për vitin		1,057,583	-	1,057,583
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>		<b>7,121,552</b>	-	<b>7,121,552</b>
Suficiti për vitin		925,828	-	925,828
Transferet në rezerva	9	(5,000,000)	5,000,000	-
Kthimi i suficitit në FKPK-MP	9	(3,000,000)	-	(3,000,000)
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>		<b>47,380</b>	<b>5,000,000</b>	<b>5,047,380</b>

**Shënim:** Detajet në lidhje me Pasqyrën e ndryshimeve në mjetet neto të operacioneve përshkruhen në Shënimet 9 deri 10 të këtyre Pasqyrave Financiare.

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Shënimet	Për fund vitin 31 dhjetor 2013 EUR	Për fund vitin 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operacionale</b>		
Suficiti për vitin	925,828	1,057,583
<b>Rregullimet për:</b>		
Zhvlerësim dhe amortizim	103,319	73,279
Të hyrat nga grantet	-	(100,280)
	<b>1,029,147</b>	<b>1,030,582</b>
<b>Ndryshimet në mjetet dhe detyrimet operacionale:</b>		
Rritja në llogaritë e pagueshme/akruale	146,140	64,876
Zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme/parapagimet	174,418	18,552
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operacionale</b>	<b>1,349,705</b>	<b>1,114,010</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e pajisjeve	(144,208)	(28,251)
Blerja e softuerëve dhe licencave	(53,966)	(278,981)
Zvogëlimi në investimet që mbahen deri në maturim	2,000,000	900,000
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>1,801,826</b>	<b>592,768</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Kthimi i suficitit në FKPK-MP	9	(3,000,000)
Kthimi i grantit	-	(1,484,828)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>(3,000,000)</b>	<b>(1,484,828)</b>
<b>Rritja e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj</b>	<b>151,531</b>	<b>221,950</b>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	736,610	514,660
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>888,141</b>	<b>736,610</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 16 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje “FKPK”), regjistruar në adresën: Rr. Agim Ramadani Nr. 10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplimentuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të aseteve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Një anëtar pa të drejtë vote i përfaqëson interesat e Qeverisë.

Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm i menaxhuan operacionet ditore të FKPK-së gjatë vitit 2013 (2012: Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm).

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### 2.1 Deklarata e përputhjes

Pasqyrat financiare të FKPK-O janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

### 2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-ja i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare sipas konventës së kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i mjeteve financiare, detyrimeve financiare, pronës dhe pajisjeve.

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalesjet

#### (a) Standardet e reja apo të ndryshuara në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013

Një numër i standardeve të reja apo të ndryshuara janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013. Informacione mbi këto standard të reja janë paraqitur në vijim:

#### SNRF 10 ‘Konsolidimi i Pasqyrave Financiare’ (SNRF 10)

SNRF 10 mbizotëron SNK 27 ‘Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta’ (SNK 27) dhe KPI 12 ‘Konsolidimi – Subjektet me Qëllim të Posaçëm’. SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit dhe ofron udhëzues të hollësishëm për aplikimin e tij. Këto kërkesa të reja kanë potencialin për të afektuar se cilët nga të investuarit e FKPK-O konsiderohen si vartëse duke ndryshuar kështu shtrirjen e konsolidimit. Kërkesat për procedurat e konsolidimit, kontabilizimin e ndryshimeve në interesat jo-kontrolluese, si dhe kontabilizimin e humbjes së kontrollit të një vartësi nuk kanë ndryshuar.

Menaxhmenti ka shqyrtuar vlerësimin e kontrollit sipas SNRF 10 dhe ka konkluduar se nuk ka efekt në klasifikime (qoftë si vartëse ose ndryshe) për asnjërin nga të investuarit e FKPK-O gjatë periudhës ose periudhave krahasuese të mbuluara me këto pasqyra financiare.

#### SNRF 11 ‘Aranzhimet e Përbashkëta’ (SNRF 11)

SNRF 11 e mbizotëron SNK 31 ‘Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta’ (SNK 31) dhe KPI 13 ‘Entitetet e kontrolluara bashkarisht – Kontributet jo-monetare nga Sipërmarrësit’. SNRF 11 ndryshon kategorizimin e aranzhimeve të përbashkëta si dhe kriteret për klasifikimin nëpër kategori, me qëllim të përafërimit të kontabilizimit me të drejtat dhe obligimet e investitorëve që ndërlidhen me aranzhimin. Po ashtu, opsioni i SNK 31 për të shfrytëzuar konsolidimin proporcional për aranzhimet e klasifikuara si entitete të kontrolluara bashkarisht sipas të njëjtit Standard është hequr. SNRF 11 tani kërkon përdorimin e metodës së kapitalit për aranzhimet e klasifikuara si sipërmarrje të përbashkëta (sikur tek investimet në shoqëri të asociuar).

Adoptimi i SNRF 11 nuk ka ndikim mbi pasqyrat financiare të FKPK-O.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

#### (a) Standardet e reja apo të ndryshuara në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013 (Vazhdim)

##### SNRF 12 'Shpalosja e interesave në entite të tjera' (SNRF 12)

SNRF 12 e integron dhe i bën konsistente kërkesat për shpalosje për llojet e ndryshme të investimeve, përfshirë entitet e strukturuar që nuk janë konsoliduar. Paraqet kërkesa të reja për shpalosje lidhur me rreziqet të cilave i ekspozohet një entitet nga involvimi i tij me entitete të strukturuar.

Adoptimi i SNRF 11 nuk ka ndikim material mbi pasqyrat financiare të FKPK-O.

##### Ndryshimet pasuese të SNK 27 'Pasqyrat e veçanta financiare' (SNK 27) dhe SNK 28 'Investimet në shoqëri të asociuara dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta' (SNK 28)

SNK 27 tani merret vetëm më pasqyrat e veçanta financiare. SNK 28 sjell në fushëveprimin e saj investimet në sipërmarrjet e përbashkëta. Megjithatë, metoda e kapitalit për përlogaritje mbetet e njëjtë.

##### SNRF 13 'Matja e vlerës reale' (SNRF 13)

SNRF 13 sqaron definicionin e vlerës reale dhe i ofron udhëzimet përkatëse dhe shpalosjet e përmirësuara për llogaritjen e vlerës reale. Ky standard nuk ndikon mbi atë se cilët artikuj duhet të maten sipas vlerës reale. Fushëveprimi i SNRF 13 është i gjerë dhe aplikohet si për elemente financiare ashtu edhe për ato jo-financiare për të cilat SNRF-të kërkojnë ose lejojnë vlerësimin sipas vlerës reale, ose për shpalosjet e matjeve sipas vlerës reale përpos në disa raste të caktuara.

SNRF 13 aplikohet prospektivisht për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013. Kërkesat për shpalosje nuk janë obligative për informacionet krahasuese në vitin e parë të adoptimit. Megjithatë, FKPK-O ka përfshirë e informacionet krahasuese sipas IFRS 13 për shpalosjet të cilat paraprakisht të kërkuara sipas SNRF 7 'Instrumentet financiare – Shpalosjet'.

FKPK-O në vitin aktual për herë të parë e ka adoptuar IFRS 13.

##### Ndryshimet në SNK 19 'Përfitimet e punonjësve' (SNK 19)

Ndryshimet në SNK 19 bënë një numër të ndryshimeve në përlogaritjen e përfitimeve të punonjësve, më të rëndësishmet nga të cilat ndërlihen me planet me përfitim të definuar. Ndryshimet:

- eliminojnë "metodën e korridorit" dhe kërkojnë njohjen e rivlerësimeve (përfshirë fitimet apo humbjet aktuale) të cilat lindin në periudhën raportimit tek të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse;
- ndryshojnë vlerësimin dhe prezantimin e disa përbërësve të kostove të përfitimeve të definuara. Vlera neto e fitimit apo humbjes ndikohet nga, heqja e kthimeve të pritura nga mjetet e planit si dhe përbërësve të kostos së interesit, dhe zëvendësimi i tyre me shpenzimet apo të hyrat neto të interesit bazuar në përfitimet e definuara neto të mjeteve dhe detyrimeve;
- përmirësojnë shpalosjet, duke përfshirë më tepër informacione rreth karakteristikave të planit për përfitim të definuar dhe rreziqeve përkatëse.

Adoptimi i ndryshimeve në SNK 19 nuk ka ndikim mbi pasqyrat financiare të FKPK-O.

#### (b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe të cilat nuk janë adoptuar para kohës nga FKPK-ja

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK por nuk janë ende në fuqi, dhe nuk janë adoptuar para kohës nga FKPK.

Menaxhmenti parashikon që të gjitha shpalljet relevante do të adoptohen në politikat kontabël të FKPK-së në periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes së tyre. Informacionet për standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që pritet të jenë relevante për pasqyrat financiare të FKPK-O prezantohen më poshtë. Disa standarde dhe interpretime të tjera të reja janë shpallur por nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-O.

##### SNRF 9 'Instrumentet financiare' (SNRF 9)

BSNK synon të zëvendësojë në tërësi SNK 39 'Instrumentet financiare: Njohja dhe matja' (SNK 39) me SNRF 9. Deri më sot kapitujt që trajtojnë njohjen, klasifikimin, matjen dhe çnjohjen e aseteve dhe detyrimeve financiare janë shpallur. Kapitujt të cilët trajtojnë metodologjitë për rastet e dëmtimeve ende janë duke u zhvilluar. Tutje, në nëntor 2011 BSNK ndruajtur vendosi të marrë në konsideratë ndryshime të kufizuara në modelin e klasifikimit të aseteve financiare në SNRF 9 për t'i trajtuar çështjet e aplikimit. Menaxhmenti i FKPK-së nuk e ka vlerësuar ende ndikimin e këtij standardi të ri në pasqyrat financiare të FKPK-O. Menaxhmenti nuk parasheh ta implementojë SNRF 9 para se ai të kompletohet dhe të mund të vlerësohet impakti i plotë i tij.

## 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

### 3.1 Njohja e të hyrave

Tarifa është përlogaritur në baza ditore duke i ngarkuar me norma specifike bilancet ditore të bruto mjeteve pensionale.

Interesat nga depozitat bankare njihen në baza akruale.

### 3.2 Grantet e qeverisë

Grantet e Qeverisë njihen në vlerën e tyre të drejtë, nëse ka garanci të arsyeshme se granti do të pranohet si dhe të gjitha kushtet përcjellëse do të përmbushen. Kur granti ka të bëjë me një zë shpenzimi, ai njihet si e hyrë përgjatë periudhave të nevojshme për të përputhur grantin në bazë sistematike me koston të cilën tenton ta kompensojë. Kur granti ka të bëjë për ndonjë pasuri, vlera e tregut i kreditohet kontos së të hyrave të shtyera dhe lirohen në pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse përgjatë jetës së dobishme të pritur të pasurisë përkatëse.

### 3.3 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, impiantet dhe pajisjet e operacioneve të FKPK-së përbëhen nga: Kompjuterë dhe pajisje të ngjajshme; Mobilje, instalime dhe pajisje të ngjajshme; Pajisje të tjera të zyrës; dhe Automjete; të cilët barten si kosto minus zhvlerësimin e akumuluar. Vlera bartëse e pajisjeve rishikohet për dëmtime kur ngjarjet ndryshojnë ose në rast se ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera bartëse nuk është e rikuperueshme. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla, dhe aty ku vlera bartëse e tejkalon shumën e rikuperueshme të vlerësuar, mjetet regjistrohen në shumën e tyre të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e pajisjeve të tilla është më e madhja në mes të çmimit neto të shitjes dhe vlerës përdoruese.

Në vlerësimin e vlerës përdoruese, rrjedhat e ardhshme të parashikuara të parasë zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur normën e zbritjes para-tatimore e cila e reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë si dhe rreziqeve përkatëse për mjetet.

Humbjet nga dëmtimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Zhvlerësimi ngarkohet në bazë të metodës drejtvizore përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të mjeteve, duke i përdorur normat si në vijim:

Kompjuterët dhe pajisjet e ngjajshme – 33%

Mobiljet, instalimet dhe pajisjet – 20%

Pajisjet e tjera të zyrës – 20%

Veturat – 20%.

### 3.4 Mjetet e patrupëzuara

Mjetet e patrupëzuara përbëhen nga softuerët e licencuar kompjuterik. Këto fillimisht paraqiten sipas kostos dhe më pas sipas kostos së tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga prishjet, nëse ka të tilla.

Amortizimi regjistrohet kur këto mjete janë të disponueshme për përdorim sipas metodës drejtvizore ku kostoja e mjetit të patrupëzuar shlyhet përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit, duke i përdorur normat si në vijim:

Softuerët – 20%

Licencat amortizohen sipas kohëzgjatjes së licencës.

### 3.5 Instrumentet financiare

Mjetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë: investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si mjete, detyrime apo ekuitete në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra neto. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-ja ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një mjet dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.6 Investimet

Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit. Data e tregtimit është data kur FKPK-ja zotohet për blerjen apo shitjen e mjetit.

##### Investimet e mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim përfaqësohen nga depozitat dhe investimet me pagesa fikse apo të paracaktuara si dhe maturiteti fiks të cilat FKPK-O ka qëllim pozitiv por edhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Depozitat me afat original të maturimit prej tre muaj ose më pak klasifikohen si ekuivalentë të parasë së gatshme për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, ndërsa ato me afat maturimi më të gjatë se tre muaj klasifikohen si investime të mbajtura deri në maturim.

Interesi përlogarit në baza akruale dhe interesi i arkëtueshëm reflektohet në të arkëtueshme tjera. Fletobligacionet e Qeverive ose Thesareve në kohën e përvetësimit vlerësohen sipas vlerave të tyre të diskontuara, ndërkohë që vlerësimet pasuese bëhen në vlerat e amortizuara të tyre.

##### Investimet e disponueshme për shitje

Mjetet e FKPK-së të investuara në fondet e përbashkëta për investime të hapura janë të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Këto investime fillimisht njihen sipas kostos, që është vlera e drejtë e shumës së dhënë.

Pas njohjes fillestare, investimet në fondet e përbashkëta për investime të hapura rivlerësohen sipas vlerës së drejtë duke u bazuar në çmimet e kuotuar në mbyllje të tregtimit në datën e raportimit.

##### Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

##### Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i rënditë mjetet dhe detyrimet financiare në tre nivele të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1:** Çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për mjete dhe detyrime identike;
- Niveli 2:** Shënimet tjera hyrëse, mënjanë nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e mjeteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe
- Niveli 3:** Shënimet hyrëse për mjetet dhe detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

Në datat e raportimit, FKPK-O nuk ka pasur instrumente financiare që maten sipas vlerës së drejtë, qofshin ato asete ose detyrime. Kjo për faktin se tepricat absolute të likuiditetit të FKPK-O investohen vetëm në depozita me afat ose në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës, duke bërë që ato të mos jenë të ekspozuara ndaj asnjë risku financiar me përjashtim të rrezikut nga falimentimi i vetë bankave me të cilat janë afatizuar depozitat apo shteti i Kosovës.

##### Dëmtimi

Dëmtimi i investimeve njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ka rënie të përhershme të vlerës së tyre.

#### 3.7 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre apo më pak muajsh.

#### 3.8 Tatimi

FKPK-ja si fond i mirëbesimit është i liruar nga tatimi në fitim të korporatave.

#### 3.9 Kostoja e pensionit

FKPK-ja nuk mban provizione e as nuk ka kurrfarë obligimi ndaj pensioneve të të punësuarve, përtej kontributeve të paguara në skemën e lartpërmendur të pensioneve.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.10 Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga menaxhmenti që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumën e raportuara të mjeteve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe periudhat e ardhshme që mund të ndikohen. Informacionet mbi sferat materiale me pasiguri të madhe të vlerësimin dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në vijim:

##### Jeta e dobishme e pasurive të cilat i nënshtrohen amortizimit

Menaxhmenti ka rishikuar jetëgjatësinë e pasurive të cilat i nënshtrohen amortizimit më 31 dhjetor 2013. Menaxhmenti ka vlerësuar jetëgjatësinë e pasurive përfaqëson dobishmërinë e pritshme të tyre. Vlerat bartëse të pasurive të tilla janë analizuar në Shënimin 8. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të vjetërsimit teknologjik.

#### 3.11 Menaxhimi i riskut financiar

##### 3.11.1 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-O nëse klienti apo pala tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale, dhe paraqitet kryesisht nga depozitat e FKPK-së në banka, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj, dhe investimet në instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës; pa ekspozim ndaj këtyre të fundit në datën e raportimit.

##### 3.11.2 Risku i likuiditetit

Menaxhimi i kujdesshëm i riskut të likuiditetit nënkupton mbajtjen e mjaftueshme të parasë së gatshme, qasje në fonde përmes mekanizmave adekuatë për kredi, si dhe aftësisë për të arkëtuar në kohë – sipas kushteve të paracaktuara – shumat e pritshme nga palët e treta.

Tabela në vijim paraqet maturimet e mbetura kontraktuale të mjeteve dhe detyrimeve financiare të FKPK-O. Tabela është përpiluar në bazë të rrjedhës së pazbritur të parasë të detyrimeve financiare.

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	Afatshkurtër Deri në 1 vit	Afatshkurtër Deri në 1 vit
	EUR	EUR
<b>Mjetet financiare</b>		
Paraja në dorë dhe në bankë	888,141	736,610
Investimet që mbahen deri në maturim	4,000,000	6,000,000
Llogaritë e arkëtueshme	350,373	547,927
	<b>5,238,514</b>	<b>7,284,537</b>
<b>Detyrimet financiare</b>		
Llogaritë e pagueshme	629,542	483,402
	<b>629,542</b>	<b>483,402</b>
<b>Hendeku i maturimit</b>	<b>4,608,972</b>	<b>6,801,135</b>

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.11 Menaxhimi i riskut financiar (Vazhdim)

##### 3.11.3 Risku i tregjeve

Risku i tregjeve është risku që ndryshimet në çmimet e tregjeve, për shembull normat e këmbimit valutor dhe normat e interesit do të ndikojnë të hyrat e FKPK-O ose vlerën e instrumenteve financiare në posedim të tij. Qëllimi i menaxhimit të riskut të tregjeve është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregjeve përbrenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimet.

##### Risku i këmbimit valutor

Mjetet dhe detyrimet e FKPK-O nuk janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve në normat e këmbimit valutor meqë të gjitha transaksionet bëhen në valutën vendore.

##### Risku i normave të interesit

Risku i normave të interesit është risku që vlera reale ose vlera e rrjedhave të ardhshme të parasë të një instrumenti financiar do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Menaxhmenti i FKPK-së kryesisht është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit neto të riskut të normave të interesit, dhe vendos kufijtë për të reduktuar potencialin e mospërputhjes së normave të interesit. FKPK-O nuk kishte mjetet që bartnin interes variabil, apo mjetet të huazuara nga institucionet financiare vendore apo të huaja në datën e pozicionit financiar.

	Më 31 dhjetor 2013		Më 31 dhjetor 2012	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Që bartin interes</b>				
<i>Normë fikse</i>				
Investimet që mbahen deri në maturim	4,000,000	-	6,000,000	-
<b>Gjithsej</b>	<b>4,000,000</b>	<b>-</b>	<b>6,000,000</b>	<b>-</b>

##### 3.11.4 Instrumentet financiare që nuk janë të prezantuara sipas vlerës së drejtë

Tabela në vijim përmbledhë vlerat bartëse dhe të drejta për ato mjete dhe detyrime financiare që nuk janë paraqitur sipas vlerës së tyre të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

	Më 31 dhjetor 2013		Më 31 dhjetor 2012	
	Vlera bartëse	Vlera reale	Vlera bartëse	Vlera reale
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Mjetet financiare</b>				
Paraja në dorë dhe në bankë	888,141	888,141	736,610	736,610
Investimet që mbahen deri në maturim	4,000,000	4,000,000	6,000,000	6,000,000
Llogaritë e arkëtueshme	350,373	350,373	547,927	547,927
	<b>5,238,514</b>	<b>5,238,514</b>	<b>7,284,537</b>	<b>7,284,537</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogaritë e pagueshme	629,542	629,542	483,402	483,402
	<b>629,542</b>	<b>629,542</b>	<b>483,402</b>	<b>483,402</b>

### 4 PARAJA NË DORË DHE NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Raiffeisen Bank Kosovo – Llogari rrjedhëse	278,688	548,079
ProCredit Bank – Llogari rrjedhëse	481,482	93,822
NLB Prishtina – Llogari rrjedhëse	124,782	90,285
Raiffeisen Bank International (Austria) – Llogari rrjedhëse	2,673	4,391
Paraja në dorë	516	33
<b>Gjithsej paraja në dorë dhe në bankë</b>	<b>888,141</b>	<b>736,610</b>

### 5 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM

	Shënimet	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
		EUR	EUR
Depozitat me afat	5.1	4,000,000	6,000,000
Instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës	5.2	-	-
<b>Gjithsej investimet që mbahen deri në maturim</b>		<b>4,000,000</b>	<b>6,000,000</b>

#### 5.1 Depozitat me afat

Depozitat me afat më datë 31 dhjetor 2013, në shumë prej 4,000,000 euro (2012: 6,000,000 euro) përfaqësojnë depozitat në bankat lokale me afat origjinal të maturimit prej 12 muajsh. Depozitat me afat bartnin norma vjetore të interesit prej 2.63% - 2.90% (2012: 4.8% - 5.5%).

## 5 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

### 5.2 Instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës

	2013	2012
	EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	-	-
<b>Plasmanet</b>		
KV1102320237 T-Bill Mat. 20.11.2013 @0.95%	2,488,114	-
	<b>2,488,114</b>	-
<b>Interesi</b>		
KV1102320237 T-Bill Mat. 20.11.2013 @0.95%	11,886	-
	<b>11,886</b>	-
<b>Tërheqjet (pas maturimit)</b>		
KV1102320237 T-Bill Mat. 20.11.2013 @0.95%	(2,500,000)	-
	<b>(2,500,000)</b>	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	-	-

Në datën e raportimit nuk kishte investime në fletobligacione të Qeverisë së Kosovës, të cilat janë ende pa rejting. Kur ka investime në instrumente të tilla është qëllim i Bordit Drejtues që investimet e FKPK-O në instrumente borxhi të Thesarit të Kosovës t'i mbajë deri në maturim.

## 6 LLOGARITË E ARKËTUESHME

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Të arkëtueshmet nga FKPK-MP	294,010	414,306
Rabatet e arkëtueshme nga fonde për investime të hapura	31,368	-
Të arkëtueshmet tjera	24,995	133,621
<b>Gjithsej llogaritë e arkëtueshme</b>	<b>350,373</b>	<b>547,927</b>

Më 31 dhjetor 2013 vlera e të arkëtueshmeve nga FKPK-MP në shumë prej 294,010 euro (2012: 414,306 euro) ka të bëjë me tarifën e ngarkuar mbi llogaritë e pjesëmarrësve në shumë 292,357 euro (2012: 290,047 euro) si dhe diferencat nga refondimet e kontributeve të gabuara në shumë 1,653 euro (2012: 124,259 euro); të cilat nuk u arkëtuan deri në datën e raportimit.

## 7 PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Kompjuterët dhe pajisjet e ngjajshme	Mobiljet instalimet dhe pajisjet	Pajisjet e tjera të zyrës	Veturat	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Kostoja</b>					
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>126,135</b>	<b>21,468</b>	<b>39,270</b>	<b>53,365</b>	<b>240,238</b>
Shtesat gjatë vitit	28,251	-	-	-	28,251
Hudhjet gjatë vitit	(34,661)	(1,653)	(3,969)	-	(40,283)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>119,725</b>	<b>19,815</b>	<b>35,301</b>	<b>53,365</b>	<b>228,206</b>
Shtesat gjatë vitit	128,525	1,639	14,044	-	144,208
Hudhjet gjatë vitit	(5,408)	(738)	(909)	-	(7,055)
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>242,842</b>	<b>20,716</b>	<b>48,436</b>	<b>53,365</b>	<b>365,359</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>					
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>(106,039)</b>	<b>(17,329)</b>	<b>(22,239)</b>	<b>(35,739)</b>	<b>(181,346)</b>
Ngarkesa gjatë vitit	(17,639)	(2,253)	(4,848)	(4,598)	(29,338)
Të eliminuara me hudhjet	34,661	1,653	3,969	-	40,283
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(89,017)</b>	<b>(17,929)</b>	<b>(23,118)</b>	<b>(40,337)</b>	<b>(170,401)</b>
Ngarkesa gjatë vitit	(31,562)	(1,131)	(5,156)	(4,598)	(42,447)
Të eliminuara me hudhjet	5,408	738	909	-	7,055
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>(115,171)</b>	<b>(18,322)</b>	<b>(27,365)</b>	<b>(44,935)</b>	<b>(205,793)</b>
<b>Vlera neto në libra</b>					
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>127,671</b>	<b>2,394</b>	<b>21,071</b>	<b>8,430</b>	<b>159,566</b>
	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>30,708</b>	<b>1,886</b>	<b>12,183</b>	<b>13,028</b>	<b>57,805</b>

## 8 MJETET E PATRUPËZUARA

	Softuerët dhe Licencat
	EUR
<b>Kostoja</b>	
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>301,066</b>
Shtesat gjatë vitit	278,981
Hudhjet gjatë vitit	(294,215)
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>285,832</b>
Shtesat gjatë vitit	53,966
Hudhjet gjatë vitit	-
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>339,798</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
<b>Më 1 janar 2012</b>	<b>(295,509)</b>
Ngarkimi gjatë vitit	(43,941)
Të eliminuara prej hudhjeve	294,215
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>(45,235)</b>
Ngarkimi gjatë vitit	(60,872)
Të eliminuara prej hudhjeve	-
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>(106,107)</b>
<b>Vlera neto në libra</b>	
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>233,691</b>
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>240,597</b>

## 9 SUFICITET

	Aktivitetet e përbashkëta	Aktivitetet operacionale	Aktivitetet investuese	Gjithsej
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Të hyrat për vitin 2013</b>				
<b>Të hyrat tarifore</b>				
1 janar – 19 maj 2013	1,796,645	-	-	1,796,645
20 maj – 31 dhjetor 2013	-	793,250	2,009,569	2,802,819
	<b>1,796,645</b>	<b>793,250</b>	<b>2,009,569</b>	<b>4,599,464</b>
<b>Të hyrat jo-tarifore</b>				
1 janar – 19 maj 2013	138,829	-	-	<b>138,829</b>
20 maj – 31 dhjetor 2013	-	175,877	-	175,877
	<b>138,829</b>	<b>175,877</b>	<b>-</b>	<b>314,706</b>
<b>Gjithsej të hyrat për vitin 2013</b>	<b>1,935,474</b>	<b>969,127</b>	<b>2,009,569</b>	<b>4,914,170</b>
<b>Shpenzimet për vitin 2013</b>				
1 janar – 19 maj 2013	(1,574,401)	-	-	(1,574,401)
20 maj – 31 dhjetor 2013	-	(638,322)	(1,775,619)	(2,413,941)
<b>Gjithsej shpenzime për vitin 2013</b>	<b>(1,574,401)</b>	<b>(638,322)</b>	<b>(1,775,619)</b>	<b>(3,988,342)</b>
<b>Suficiti për vitin 2013</b>	<b>361,073</b>	<b>330,805</b>	<b>233,950</b>	<b>925,828</b>
Suficiti në fillim të vitit	7,121,552	-	-	7,121,552
Transferet në rezerva	(5,000,000)	-	-	(5,000,000)
Kthimi i suficitit në FKPK-MP	(2,482,625)	(283,425)	(233,950)	(3,000,000)
<b>Suficiti në fund të vitit</b>	<b>-</b>	<b>47,380</b>	<b>-</b>	<b>47,380</b>

Gjatë prillit 2013 Bordi Drejtues vendosi të krijojë një rezervë prej maksimum 5 milion euro. Mjetet nga rezerva do të mund të përdoren vetëm me miratimin e Bordit në rast të ndodhjeve të jashtëzakonshme dhe rrethanave të pa parashikuara. Rezerva fillimisht është financuar prej suficitit nga aktivitetet e përbashkëta. Me t'u përdorur mjetet nga rezerva, kjo e fundit do të rimbushet prej suficitit nga aktivitetet operacionale.

Në këto pasqyra financiare aktivitetet e FKPK-Operacioneve para datës 20 maj 2013 iu është referuar si "Aktivitetet e përbashkëta". Për shkak të ndryshimeve në ligj, hollësitë e së cilës janë përkrahur në Shënimin 10, me fuqi nga 20 maji 2013 aktivitetet e përbashkëta janë zëvendësuar me aktivitetet investuese dhe ato operacionale, për të cilat më pas regjistrimet në kontabilitet janë mbajtur ndaras. Suficiti nga aktivitetet e përbashkëta kishte bilanc prej 7,482,625 euro në datën e fundit të akumulimit të tij, pra më 19 maj 2013. Nga ky bilanc 5,000,000 euro janë përdorur për ta financuar rezervën e përkrahur sipër.

Bordi Drejtues më pas ka vendosur që t'i kthejë në mjetet pensionale të kontribuuesve (në FKPK-MP) 3,000,000 euro prej suficiteve nga aktivitetet e përbashkëta, investuese dhe operacionale, sipas të njëjtit prioritet. Kthimi i suficitit në FKPK-MP është financuar nga: i) Suficiti nga aktivitetet e përbashkëta: 2,482,625 euro; ii) Suficiti nga aktivitetet investuese: 233,950 euro; dhe iii) Suficiti nga aktivitetet operacionale: 283,425 euro. Kjo rezultoi që të mos ketë suficit nga aktivitetet e përbashkëta e as investuese, dhe të ketë një bilanc prej 47,380 euro për suficitin nga aktivitetet operacionale, në datën e raportimit.

## 10 TARIFAT E NGARKUARA NDAJ MJETEVE PENSIONALE

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet e përbashkëta	1,796,645	3,997,932
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet investuese	2,009,569	-
Tarifat e ngarkuara për aktivitetet operacionale	793,250	-
<b>Gjithsej tarifat e ngarkuara ndaj mjeteve pensionale</b>	<b>4,599,464</b>	<b>3,997,932</b>

Tarifa përllogariten në baza ditore sipas formulës:

Tarifa = [Mjetet bruto të pjesëmarrësve] \* [Norma]/[Numri i ditëve kalendarike në vit].

Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve për qëllime të financimit të aktiviteteve të FKPK-së për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishin në shumën 4,599,464 euro (31 dhjetor 2012: 3,997,932 euro).

Para Ligjit Nr. 04/L-168 një tarifë e vetme (tarifë e përbashkët e menaxhimit) ngarkohej për financimin e aktiviteteve të përbashkëta, pra edhe aktivitetet investuese edhe ato operacionale. Megjithatë, ky ligj krijoi dy tarifa të veçanta: (i) tarifën për mbulimet e aktiviteteve që kanë të bëjnë me investimin e mjeteve pensionale dhe (ii) tarifën për mbulimin e aktiviteteve operacionale.

Nga 1 janari 2012 deri më 19 maj 2013, tarifa e përbashkët e menaxhimit u ngarkua me normë vjetore prej 0.60%. Nga 20 maji 2013 kur Kuvendi i Republikës së Kosovës – sipas ligjit të ri – aprovoi tarifën për aktivitetet investuese me një normë vjetore prej 0.38%, si dhe tarifën për aktivitetet operacionale me një normë prej 0.15%, FKPK-O ngarkoi tarifën sipas normave të reja si dhe bëri ndarjen në kontabilitet të aktiviteteve investuese dhe atyre operacionale.

## 11 TË HYRAT TJERA

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Të hyrat nga interesi i investimeve që mbahen deri në maturim	233,384	354,254
Diferenca nga refondimet e kontributeve të gabuara	71,300	126,161
Të hyrat tjera	10,022	11,262
<b>Gjithsej të hyrat tjera</b>	<b>314,706</b>	<b>491,677</b>

## 12 TARIFAT NETO TË INSTRUMENTEVE PËR INVESTIME TË HAPURA

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013			Për fund vitin 31 dhjetor 2012		
	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto
	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	1,185,522	(789,074)	396,448	949,112	(593,188)	355,924
BNY Mellon – RRF	763,930	-	763,930	485,001	-	485,001
AXA – GILB	472,252	(39,207)	433,045	385,985	-	385,985
Schroders – SISF	453,392	-	453,392	312,575	-	312,575
Aquila – RP7	625,429	-	625,429	633,154	-	633,154
State Street – EMIF	51,450	-	51,450	52,168	-	52,168
ECM – DEC	113,244	-	113,244	106,385	-	106,385
BNP Paribas – GLF	-	-	-	53,264	-	53,264
<b>Gjithsej tarifat neto</b>	<b>3,665,219</b>	<b>(828,281)</b>	<b>2,836,938</b>	<b>2,977,644</b>	<b>(593,188)</b>	<b>2,384,456</b>

## 13 SHPENZIMET PËR BORDIN DREJTUES

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Honorarët	90,403	96,250
Sigurimi fiduciar	21,503	36,242
Takimet (udhëtimet/hotelet/kostot e tjera)	31,370	21,810
Kontributet pensionale të punëdhënësit	4,638	2,686
<b>Gjithsej shpenzimet për Bordin Drejtues</b>	<b>147,914</b>	<b>156,988</b>

## 14 KOSTOJA E STAFIT

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Pagat e stafit	397,020	422,735
Puna jashtë orarit, bonuset, tarifat e mbajtjes	60,619	61,216
Kontributet pensionale të punëdhënësit	43,444	44,472
Trajnimit i punonjësve	3,573	5,001
Sigurimi shëndetësor	6,225	6,213
Udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit	12,089	7,380
<b>Gjithsej kostoja e stafit</b>	<b>522,970</b>	<b>547,017</b>

Në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012 udhëtimet dhe shpenzimet e tjera të stafit janë paraqitur nën Shpenzimet e tjera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

## 15 SHËRBIMET PROFESIONALE/KONTRAKTORËT/KONSULENTËT

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Shërbimet e përkthimit dhe korigjimit	1,688	1,556
Shërbimet e noterëve/ligjore	1,200	-
Shërbimet e auditimit të brendshëm	-	8,000
Shërbimet e kontabilitetit	-	1,700
Të tjera	32	-
<b>Gjithsej shërbimet profesionale/kontraktorët/konsulentët</b>	<b>2,920</b>	<b>11,256</b>

## 16 NGJARJET PAS PERIUdhËS SË RAPORTIMIT

Për dy muajt e parë të vitit 2014, FKPK-O i ka këto të dhëna financiare të bazuara në pasqyrat e paaudituar financiare për këta dy muaj.

	Më 28 shkurt 2014
	EUR
Gjithsej mjetet	5,600,756
Detyrimet qarkulluese	(293,469)
<b>Mjetet neto të Operacioneve</b>	<b>5,307,287</b>
	Për periudhën 1 janar - 28 shkurt 2014
	EUR
Gjithsej të hyra	807,738
Gjithsej shpenzime	(547,831)
<b>Suficiti neto</b>	<b>259,907</b>

Nuk ka ngjarje të mëvonshme që do të kërkonin korigjim ose shpalesje të mëtejshme në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013.

# FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS MJETET PENSIONALE

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Më dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2013

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	Faqet 63-64
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	Faqe 65
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSH	Faqe 66
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË MJETET NETO TË PJESËMARRËSVE	Faqe 67
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	Faqe 68
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	Faqet 69-88



## Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC  
Rr. Rexhep Mala 18  
10 000 Prishtina  
Kosovo

T +381 38 247 771  
T +381 38 247 801  
F +381 38 247 802  
[www.grant-thornton.com.mk](http://www.grant-thornton.com.mk)

Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Ne kemi audituar pasqyrat e mëposhtme financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale (FKPK-MP), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar deri më 31 dhjetor 2013, dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në mjetet neto dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar më atë datë, si dhe nga përmbledhja e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimet tjera shpjeguese.

### *Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare*

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen korrekte të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm të tillë që menaxhmenti e përcakton si të nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut për gabimet materiale në pasqyra financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në arrijtjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo edhe për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi po ashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël që bëhen nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën e opinionit tonë të auditimit.

**Opinion**

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – Mjetet Pensionale deri më 31 dhjetor 2013, performancën financiare dhe rrjedhjet e parasë për vitin e përfunduar më atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

**Theksim i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 17 të pasqyrave financiare i cili përshkruan se arkëtimet nga pjesëmarrësit në shumën prej 12,849,215 EUR nuk i janë atribuar llogarive individuale të pjesëmarrësve më 31 dhjetor 2013. Më 31 dhjetor 2012 shuma e cila nuk i ishte atribuar llogarive individuale të pjesëmarrësve ishte 17,544,647 EUR. Gjatë vitit 2013 FKPK kishte atribuar shumën prej 4,575,373 EUR në llogaritë individuale nga shuma e pa atribuar më 31 dhjetor 2012. Opinioni ynë nuk është kualifikuar për shkak të kësaj çështjeje.

Ky raport është përkthim i versionit original në anglisht; në rast të mospërputhjes do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.

*Grant Thornton LLC*  
Prishtinë, Kosovë  
16 prill 2014

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013 EUR	Më 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Mjetet</b>			
Paraja në bankë	4	209,646,903	27,328,138
Kontribute dhe të tjera të arkëtueshme	5	7,869,239	7,791,087
Investimet e disponueshme për shitje	6	650,832,621	666,319,389
Investimet në depozita bankare	7	-	16,428,599
Investimet që mbahen deri në maturim	8	53,122,905	30,048,996
		<b>921,471,668</b>	<b>747,916,209</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrimet ndaj operacioneve të FKPK-së	9	294,010	414,306
Detyrimet për aksionet e riblera	10	112,347	9,324
Jo-kontributet	11	13,334	4,892
		<b>419,691</b>	<b>428,522</b>
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>		<b>921,051,977</b>	<b>747,487,687</b>

Autorizuar për publikim nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK së dhe nënshkruar në emër të tyre më 16 prill 2014.






**Dr. Ymer Havolli**  
 Kryesuesi i Bordit Drejtues

**Z. Adrian Zalli**  
 Drejtori Menaxhues

**Z. Vërshim Hatipi**  
 Zëvendës Drejtor – Financa dhe TI

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2013 EUR	Për fund vitin 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Të hyrat</b>			
Rivlerësimi i investimeve të disponueshme për shitje – neto	12	67,528,194	53,014,121
Të hyrat nga interesi i investimeve që mbahen deri në maturim	13	430,207	588,875
Të hyrat nga interesi i depozitave bankare	7	173,172	573,471
Të hyrat nga interesi i llogarive rrjedhëse	14	-	7,603
Të hyrat e tjera	15	3,000,000	-
		<b>71,131,573</b>	<b>54,184,070</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	16	(4,599,464)	(3,997,932)
		<b>(4,599,464)</b>	<b>(3,997,932)</b>
<b>Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>		<b>66,532,109</b>	<b>50,186,138</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Kontributet e Pjesëmarrësve EUR	Fitimet e Mbajtura EUR	Gjithsej EUR
<b>Më 1 janar 2013</b>	<b>595,037,412</b>	<b>346,912</b>	<b>595,384,324</b>
Kontributet	113,557,262	-	113,557,262
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(8,351,238)	(329,844)	(8,681,082)
Riblerjet si pasojë e refondimeve	(2,832,793)	(126,162)	(2,958,955)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	50,186,138	50,186,138
<b>Më 31 dhjetor 2012</b>	<b>697,410,643</b>	<b>50,077,044</b>	<b>747,487,687</b>
Kontributet	119,291,741	-	119,291,741
Riblerjet si pasojë e tërheqjes së kursimeve	(9,674,931)	(1,074,936)	(10,749,867)
Riblerjet si pasojë e refondimeve	(1,438,393)	(71,300)	(1,509,693)
Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve	-	66,532,109	66,532,109
<b>Më 31 dhjetor 2013</b>	<b>805,589,060</b>	<b>115,462,917</b>	<b>921,051,977</b>

**Shënim.** Fitimet e mbajtura dhe kontributet nominale të pjesëmarrësve (të arkëtuara apo të tërhequra) janë paraqitur veçmas në pasqyrën e ndryshimeve në këto pasqyra financiare. Në pasqyrën e ndryshimeve në pasqyrat financiare për fund vitin 31 dhjetor 2012, të lartpërmendurat janë prezantuar së bashku.

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2013 EUR	Për fund vitin 31 dhjetor 2012 EUR
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operacionale</b>			
Fitimi për vitin		66,532,109	50,186,138
<b>Lëvizja e kapitalit punues:</b>			
Rritja e tarifave të pagueshme	9	59,651	1,666
Rritja e detyrimeve për jo-kontributete	11	8,442	1,921
<b>Rrjedha neto e parasë nga operacionet</b>		<b>66,600,202</b>	<b>50,189,725</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>			
Zvogëlimi/(Rritja) në investimet e disponueshme për shitje (Rritja) në investimet që mbahen deri në maturim		15,486,768 (23,073,909)	(133,352,691) (11,204,203)
Zvogëlimi/(Rritja) në investimet në depozita bankare		16,428,599	(573,471)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>		<b>8,841,458</b>	<b>(145,130,365)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>			
Kontributet e pranuar të pjesëmarrësve		119,156,250	113,038,633
Tërheqjet e kursimeve		(10,711,142)	(8,681,081)
Refondimet		(1,568,003)	(2,825,372)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>		<b>106,877,105</b>	<b>101,532,180</b>
<b>Rritja në para të gatshme dhe ekuivalentët të saj</b>			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit		27,328,138	20,736,598
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>4</b>	<b>209,646,903</b>	<b>27,328,138</b>

Shënimet përcjellëse prej 1 deri në 20 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## 1 TË PËRGJITHSHME

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (më tutje "FKPK"), regjistruar në adresën: Rr. Agim Ramadani Nr. 10, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, me numër të regjistrimit 90000225; është krijuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/35 më 22 dhjetor 2001, më vonë e amendamentuar me Rregulloren 2005/20, kjo më vonë e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-084 të Republikës së Kosovës, më tej e amendamentuar me Ligjin Nr. 04/L-101 të Republikës së Kosovës, dhe kjo e fundit e komplimentuar me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 04/L-168; si institucion financiar jo-për-profit me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale të kursimeve pensionale, duke siguruar investim të kujdesshëm dhe mbrojtje të asetëve pensionale, si dhe duke paguar shumat e akumuluar në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për kursime pensionale, si menaxhues i mirëbesuar që vepron në të mirë të pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.

Ligji Nr. 04/L-101 ka krijuar një program të kursimeve pensionale, të financuar nga kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve të tyre, si dhe të administruara e të investuara përmes FKPK-së. Sipas këtij sistemi të kontributeve të definuara nga të gjithë banorët e punësuar të Kosovës dhe punëdhënësit e tyre kërkohet të paguajnë kontribute pensionale (me përjashtim të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë). Secili pjesëmarrës ka llogari individuale në FKPK në të cilën kreditohen kontributet si dhe kthimi nga investimet.

FKPK-ja mbikëqyret nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga ekspertë të investimeve dhe pensione, si dhe nga përfaqësues të punëdhënësve dhe punonjësve të Kosovës. Një anëtar pa të drejtë vote i përfaqëson interesat e Qeverisë.

Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm i menaxhuan operacionet ditore të FKPK-së gjatë vitit 2013 (2012: Drejtori dhe 25 punonjës të përhershëm).

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

### 2.1 Deklarata e përputhjes

Pasqyrat financiare të FKPK-së janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

### 2.2 Bazat e përgatitjes

FKPK-MP i mbanë librat e kontabilitetit dhe i përgatitë pasqyrat financiare sipas konventës së kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i mjeteve financiare, detyrimeve financiare, pronës dhe pajisjeve. Ku ka qenë e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur paraqitjes së vitit aktual.

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet

#### (a) Standardet e reja apo të ndryshuara në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013

Një numër i standardeve të reja apo të ndryshuara janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013. Informacione mbi këto standard të reja janë paraqitur në vijim:

#### SNRF 10 'Konsolidimi i Pasqyrave Financiare' (SNRF 10)

SNRF 10 mbizotëron SNK 27 'Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta' (SNK 27) dhe KPI 12 'Konsolidimi – Subjektet me Qëllim të Posaçëm'. SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit dhe ofron udhëzues të hollësishëm për aplikimin e tij. Këto kërkesa të reja kanë potencialin për të afektuar se cilët nga të investuarit e FKPK-MP konsiderohen si vartëse duke ndryshuar kështu shtrirjen e konsolidimit. Kërkesat për procedurat e konsolidimit, kontabilizimin e ndryshimeve në interesat jo-kontrolluese, si dhe kontabilizimin e humbjes së kontrollit të një vartësi nuk kanë ndryshuar.

Menaxhmenti ka shqyrtuar vlerësimin e kontrollit sipas SNRF 10 dhe ka konkluduar se nuk ka efekt në klasifikime (qoftë si vartëse ose ndryshe) për asnjërin nga të investuarit e FKPK-MP gjatë periudhës ose periudhave krahasuese të mbuluara me këto pasqyra financiare.

#### SNRF 11 'Aranzhimet e Përbashkëta' (SNRF 11)

SNRF 11 e mbizotëron SNK 31 'Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta' (SNK 31) dhe KPI 13 'Entitetet e kontrolluara bashkarisht – Kontributet jo-monetare nga Sipërmarrësit'. SNRF 11 ndryshon kategorizimin e aranzhimeve të përbashkëta si dhe kriteret për klasifikimin nëpër kategori, me qëllim të përafërimit të kontabilizimit me të drejtat dhe obligimet e investitorëve që ndërlidhen me aranzhimin. Po ashtu, opsioni i SNK 31 për të shfrytëzuar konsolidimin proporcional për aranzhimet e klasifikuara si entitete të kontrolluara bashkarisht sipas të njëjtit Standard është hequr. SNRF 11 tani kërkon përdorimin e metodës së kapitalit për aranzhimet e klasifikuara si sipërmarrje të përbashkëta (sikur tek investimet në shoqëri të asociuar).

Adoptimi i SNRF 11 nuk ka ndikim mbi pasqyrat financiare të KPST-MP.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

#### (a) Standardet e reja apo të ndryshuara në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013 (Vazhdim)

##### SNRF 12 ‘Shpalosja e interesave në entite të tjera’ (SNRF 12)

SNRF 12 e integron dhe i bën konsistente kërkesat për shpalosje për llojet e ndryshme të investimeve, përfshirë entitetet e strukturuar që nuk janë konsoliduar. Paraqet kërkesa të reja për shpalosje lidhur me rreziqet të cilave i ekspozohet një entitet nga involvimi i tij me entitete të strukturuar.

Adoptimi i SNRF 11 nuk ka ndikim material mbi pasqyrat financiare të KPST-MP.

##### Ndryshimet pasuese të SNK 27 ‘Pasqyrat e veçanta financiare’ (SNK 27) dhe SNK 28 ‘Investimet në shoqëri të asociuara dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta’ (SNK 28)

SNK 27 tani merret vetëm më pasqyrat e veçanta financiare. SNK 28 sjell në fushëveprimin e saj investimet në sipërmarrjet e përbashkëta. Megjithatë, metoda e kapitalit për përlogaritje mbetet e njëjtë.

##### SNRF 13 ‘Matja e vlerës reale’ (SNRF 13)

SNRF 13 sqaron definicionin e vlerës reale dhe i ofron udhëzimet përkatëse dhe shpalosjet e përmirësuara për llogaritjen e vlerës reale. Ky standard nuk ndikon mbi atë se cilët artikuj duhet të maten sipas vlerës reale. Fushëveprimi i SNRF 13 është i gjerë dhe aplikohet si për elemente financiare ashtu edhe për ato jo-financiare për të cilat SNRF-të kërkojnë ose lejojnë vlerësimin sipas vlerës reale, ose për shpalosjet e matjeve sipas vlerës reale përpos në disa raste të caktuara.

SNRF 13 aplikohet prospektivisht për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2013. Kërkesat për shpalosje nuk janë obligative për informacionet krahasuese në vitin e parë të adoptimit. Megjithatë, FKPK-MP ka përfshirë e informacionet krahasuese sipas IFRS 13 për shpalosjet të cilat paraprakisht të kërkuara sipas SNRF 7 ‘Instrumentet financiare – Shpalosjet’.

FKPK në vitin aktual për herë të parë e ka adoptuar IFRS 13.

##### Ndryshimet në SNK 19 ‘Përfitimet e punonjësve’ (SNK 19)

Ndryshimet në SNK 19 bënë një numër të ndryshimeve në përlogaritjen e përfitimeve të punonjësve, më të rëndësishmet nga të cilat ndërlidhen me planet me përfitim të definuar. Ndryshimet:

- eliminojnë “metodën e korridorit” dhe kërkojnë njohjen e rivlerësimeve (përfshirë fitimet apo humbjet aktuale) të cilat lindin në periudhën raportimit tek të hyrat e tjera gjithëpërfshirëse;
- ndryshojnë vlerësimin dhe prezantimin e disa përbërësve të kostove të përfitimeve të definuara. Vlera neto e fitimit apo humbjes ndikohet nga, heqja e kthimeve të pritura nga mjetet e planit si dhe përbërësve të kostos së interesit, dhe zëvendësimi i tyre me shpenzimet apo të hyrat neto të interesit bazuar në përfitimet e definuara neto të mjeteve dhe detyrimeve;
- përmirësojnë shpalosjet, duke përfshirë më tepër informacione rreth karakteristikave të planit për përfitim të definuar dhe rreziqeve përkatëse.

Adoptimi i ndryshimeve në SNK 19 nuk ka ndikim mbi pasqyrat financiare të FKPK-MP.

## 2 BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpalosjet (Vazhdim)

#### (b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese të cilat ende nuk kanë hyrë në fuqi dhe të cilat nuk janë adoptuar para kohës nga FKPK-ja

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga BSNK por nuk janë ende në fuqi, dhe nuk janë adoptuar para kohës nga FKPK-MP.

Menaxhmenti parashikon që të gjitha shpalljet relevante do të adoptohen në politikat kontabël të FKPK-MP në periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes së tyre. Informacionet për standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që pritet të jenë relevante për pasqyrat financiare të FKPK-MP prezantohen më poshtë. Disa standarde dhe interpretime të tjera të reja janë shpallur por nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të FKPK-MP.

##### SNRF 9 ‘Instrumentet financiare’ (SNRF 9)

BSNK synon të zëvendësojë në tërësi SNK 39 ‘Instrumentet financiare: Njohja dhe matja’ (SNK 39) me SNRF 9. Deri më sot kapitujt që trajtojnë njohjen, klasifikimin, matjen dhe çnjohjen e aseteve dhe detyrimeve financiare janë shpallur. Kapitujt të cilët trajtojnë metodologjitë për rastet e dëmtimeve ende janë duke u zhvilluar. Tutje, në nëntor 2011 BSNK ndruajtur vendosi të marrë në konsideratë ndryshime të kufizuara në modelin e klasifikimit të aseteve financiare në SNRF 9 për t’i trajtuar çështjet e aplikimit. Menaxhmenti i FKPK-së nuk e ka vlerësuar ende ndikimin e këtij standardi të ri në pasqyrat financiare të FKPK-MP. Menaxhmenti nuk parasheh ta implementojë SNRF 9 para se ai të kompletohet dhe të mund të vlerësohet impakti i plotë i tij.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

#### 3.1 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve

Të ardhurat bruto përbëhen nga kthimet e instrumenteve financiare njohja dhe matja e të cilave është e shpalosur në politikat përkatëse të kontabilitetit të përfshira në këtë shënim, ku interesi nga depozitat bankare njihet në baza akruale.

Shpenzimet përbëhen nga tarifat të cilat përlogariten në baza ditore të ngarkuara me normë specifike mbi bilancin bruto të mjeteve pensionale nga operacionet e FKPK-së.

#### 3.2 Kontributet

Kontributet e pranua nga pjesëmarrësit llogariten në bazë akruale.

#### 3.3 Tërheqjet e kursimeve dhe refondimet

Tërheqjet e kursimeve, ose pagesat e benefiteve, të cilat u paguhen pjesëmarrësve ose pasardhësve të tyre, si dhe refondimet e kontributeve të gabuara, njihen në periudhën në të cilën njësitë përkatëse janë riblerë.

#### 3.4 Instrumentet financiare

Mjetet dhe detyrimet financiare të bartura në pasqyrën e pozicionit financiar përfshijnë investimet, paranë, ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Politikat kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e këtyre zërave janë të shpalosura në politikat përkatëse kontabël të përfshira në këtë shënim. Instrumentet financiare janë të klasifikuara si mjete, detyrime apo ekuitete në përputhje me thelbin e aranzhimit kontraktual përkatës. Interesi, fitimi dhe humbjet në lidhje me instrumentet financiare të klasifikuara si mjete ose detyrime, raportohen si të hyra neto. Instrumentet financiare zbriten kur FKPK-MP ka të drejtën e ushtrueshme ligjore për të bërë zbritjen dhe ka për qëllim ujdinë qoftë në bazë neto qoftë ta realizojë një mjet dhe njëkohësisht ta shlyejë detyrimin.

#### 3.5 Investimet

Të gjitha blerjet dhe shitjet e siguracioneve njihen në datën e tregtimit. Data e tregtimit është data kur FKPK-MP zotohet për blerjen apo shitjen e mjetit.

##### *Investimet e mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim përfaqësohen nga depozitat dhe investimet me pagesa fikse ose të paracaktuara si dhe maturitet fiks të cilat FKPK-MP ka qëllimin pozitiv por edhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Depozitat me afat origjinal të maturimit prej tre muaj ose më pak klasifikohen si ekuivalentë të parasë për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, ndërsa ato me afat maturimi më të gjatë se tre muaj klasifikohen si investime të mbajtura deri në maturim.

Interesi përlogaritet në baza akruale dhe interesi i arkëtueshëm reflektohet në të arkëtueshmet e tjera. Fletobligacionet e Qeverive ose Thesareve në kohën e përvetësimit vlerësohen sipas vlerave të tyre të diskontuara, ndërkohë që vlerësimet pasuese bëhen në kostot e amortizuara të tyre.

##### *Investimet e disponueshme për shitje*

Mjetet e FKPK-MP të investuara në fondet e përbashkëta për investime të hapura janë të klasifikuara si të disponueshme për shitje. Këto investime fillimisht njihen sipas kostos, që është vlera e drejtë e shumës së dhënë.

Pas njohjes fillestare, investimet në fondet e përbashkëta për investime të hapura rivlerësohen sipas vlerës së drejtë duke u bazuar në çmimet e kuotuar në mbyllje të tregtimit në datën e raportimit.

##### *Përcaktimi i vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë paraqet shumën që do të pranohej me rastin e shitjes së një aseti ose shumën që do të duhej paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

##### *Instrumentet financiare të matura sipas vlerës së drejtë*

Mjetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar paraqiten në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë. Kjo hierarki i rënditë asetet dhe detyrimet financiare në tre nivele të cilat bazohen në rëndësinë e shënimeve hyrëse gjatë matjes së vlerës së drejtë të mjeteve financiare:

- Niveli 1:** Çmimet e kuotuar (jo të përshtatura) në tregjet aktive për mjete dhe detyrime identike;
- Niveli 2:** Shënimet tjera hyrëse, mënjanë nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 të cilat janë në dispozicion për observimin e mjeteve ose detyrimeve, drejtpërdrejt (d.m.th. si çmime) ose indirekt (d.m.th. të bëra nga çmimet); dhe
- Niveli 3:** Shënimet hyrëse për mjetet dhe detyrimet të cilat nuk bazohen në shënimet në dispozicion për observim të tregut.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.5 Investimet (Vazhdim)

Deri në datën e raportimit, instrumentet financiare të FKPK-MP të matura sipas vlerës së drejtë paraqiten si në vijim:

Klasa e investimeve	Niveli	Më 31 dhjetor 2013 EUR	Më 31 dhjetor 2012 EUR
Instrumente për investime të hapura	1	650,832,621	666,319,389

Matjet e vlerës së drejtë të listuara sipër janë periodike. Nuk ka pasur lëvizje të mjeteve në mes të niveleve gjatë viteve që kanë përfunduar më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

##### *Dëmtimi*

Dëmtimi i investimeve njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ka rënie të përhershme të vlerës së tyre.

#### 3.6 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Për qëllime të rrjedhës së parasë, paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga paraja në bankë, paraja në dorë dhe depozitat afatshkurtra me afat origjinal të maturimit prej tre apo më pak muajsh. Përfshihen investimet në depozita bankare pa datë maturimi por me afat paralajmërimi dhe të cilat Bordi Udhëheqës nuk ka për qëllim t'i shesë.

#### 3.7 Tatimi

Mjetet pensionale të FKPK-së janë të liruara nga tatimi në fitim i korporatave.

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar

Detyrimet ndaj pjesëmarrësve të FKPK-MP janë gjithmonë në vlerë të njëjtë me vlerën neto të mjeteve të pjesëmarrësve, pra nuk ka hendek financimi për benefitet e ardhshme, për ç'arsye FKPK-MP nuk bën vlerësime aktuale. Detyrimet e FKPK-MP nuk përbëhen nga asnjë instrument financiar, p.sh. mjete të huazuara nga institucione të tjera financiare, çfarë edhe e bën jo të nevojshëm menaxhimin e riskut për pjesën e detyrimeve të FKPK-MP.

Kur është në pyetje vlerësimi i riskut të instrumenteve financiare të cilat përbëjnë pjesën e mjeteve të FKPK-MP, pjesa dërrmuese e investimeve janë përmes instrumenteve për investime të hapura, që nënkupton se menaxhimi i riskut në baza ditore i është besuar menaxhuesve të këtyre instrumenteve. Si rezultat, mjetet financiare të FKPK-së i ekspozohen drejtpërdrejt vetëm një numri të vogël risqesh (kryesisht riskut të çmimit) dhe atë vetëm me një pjesë të kufizuar të mjeteve, të cilat risqe Bordi Drejtues synon t'i menaxhojë përmes politikës së investimeve.

Politika e investimeve kërkon mbi të gjitha që mjete e investuara, qoftë direkt ose indirekt, të jenë të diversifikuara mirë përgjatë emetuesve dhe klasave të aseteve, si dhe përgjatë qasjes investuese të instrumenteve për investime të hapura. Tutje, si mënyrë për menaxhim të risqeve direkte, politika vendos kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente të klasave të caktuara të aseteve (Me vetëm aksione: 50%; Me klasa mikse të aseteve: 40%; Me vetëm fletobligacione: 30%; dhe Tregje të parasë dhe bono thesari të Kosovës: 10%); si dhe kufizime për pjesën e mjeteve që mund të investohen në instrumente me qasje të caktuar investuese (Me Kthim drejtimor/Kthim pa përshtatje për risk: 55%; Me Target risku/Menaxhim risku/Kthim absolut: 40%; dhe Me të ardhura: 25%). Në përputhje me këtë kornizë Bordi Drejtues merr vendime të rrisë apo zvogëlojë ekspozimin ndaj një instrumenti të caktuar për investime të hapura varësisht nga performanca dhe plasmanet e instrumentit, ose korrelacionit të tij me instrumentet e tjera, si dhe bindjet për perspektivën afatshkurtes dhe afatmesëm për klasën e aseteve dhe qasjen investuese të instrumentit në fjalë. FKPK nuk aranzhon kontrata në avancë (forwards), shkëmbime (swaps) ose derivate të tjera (derivatives) për të menaxhuar dhe kontrolluar këto risqe për mjetet e FKPK-MP.

Departamenti i financave i FKPK-së çdo tre muaj analizon pajtueshmërinë e investimeve direkte, por edhe investimeve indirekte përmes portofliove të instrumenteve për investime të hapura, me politikat investuese të FKPK-së. Risku dhe luhshmëria e investimeve direkte dhe indirekte po ashtu vlerësohet çdo tre muaj. Të gjeturat shqyrtohen nga Komisioni i investimeve i Bordit Drejtues të FKPK-së, dhe shërbejnë si ndihmë në vendimmarrje për investimet.

Në vijim prezantohen risqet kryesore të cilave direkt iu ekspozoheshin asetet e FKPK-MP në datën e raportimit:

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar (Vazhdim)

##### 3.8.1 Risku valutor

Në datën e raportimit plasmanet në fletobligacionet e Thesarit të Kosovës ishin të gjitha në valutën euro. Si mjet për menaxhimin e riskut valuator në instrumentet për investime të hapura, politika e investimeve e FKPK lejon që maksimum 10% e mjeteve të jenë të investuara në instrumente jo të denominuara në euro ose me mbrojtje për euro.

Instrumentet për investime të hapura në të cilat FKPK kishte investime në datën e raportimit ishin të gjitha të denominuara në euro ose me mbrojtje për euro; ku menaxhuesit e këtyre instrumenteve përdorin derivate të valutës për të menaxhuar dhe kontrolluar riskun valutor.

	Më 31 dhjetor 2013		Më 31 dhjetor 2012	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Ekspozimi direkt valutor/pa mbrojtje</b>				
USD	-	-	33,028,458	-
<b>Gjithsej</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>33,028,458</b>	<b>-</b>

Meqë nuk ka patur ekspozim direkt ndaj riskut valutor në datën e raportimit, nuk janë bërë analiza sensitiviteti në efektin e ndryshimeve të valutës në të ardhurat gjithëpërfshirëse për fund vitin më 31 dhjetor, 2013. Por, një rritje/ulje prej 10% e dollarit amerikan kundrejt euros në datën e raportimit për periudhën krahasuese do të kishte rezultuar në 3,302,846 euro rritje, respektivisht ulje, të të ardhurave gjithëpërfshirëse për fund vitin më 31 dhjetor, 2012.

##### 3.8.2 Risku i normës së interesit

Risku i normave të interesit është risku që vlera reale e rrjedhave të ardhshme të parasë nga instrumentet financiare do të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në tregje. Në datën e raportimit FKPK-MP kishte investime direkte në instrumente që mbahen deri në maturim të cilat kishin normë fikse të interesit, ndërkaq nuk kishte investime direkte në instrumente financiare me normë variabile të interesit.

	Më 31 dhjetor 2013		Më 31 dhjetor 2012	
	Mjetet	Detyrimet	Mjetet	Detyrimet
	EUR	EUR	EUR	EUR
<b>Normë fikse</b>				
Investimet që mbahen deri në maturim	53,122,905	-	30,048,996	-
Investimet në dopozita bankare	-	-	16,428,599	-
<b>Gjithsej</b>	<b>53,122,905</b>	<b>-</b>	<b>46,477,595</b>	<b>-</b>

##### 3.8.3 Risku i likuiditetit

Mesatarja mujore e riblerjeve nga FKPK-MP përmes tërheqjeve të kursimeve dhe refondimeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 ishte 1,021,630 euro (2012: 970,003 euro). Kontributet mesatare mujore të arkëtuara për vitin, në shumë prej 9,940,978 euro (2012: 9,418,886), vazhduan të jenë dukshëm më të larta se sa të dalurat mujore.

Të gjitha investimet përmes instrumenteve për investime të hapura mund të shpengohen brenda 1 deri 30 ditë, dhe të gjitha investimet e mjeteve të FKPK-MP-së në instrumente të borxhit të Thesarit të Kosovës maturojnë më pak se një vit nga data e raportimit.

### 3 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.8 Menaxhimi i riskut financiar (Vazhdim)

##### 3.8.4 Risku i çmimit

Përkundër uljes së moderuar të ndryshimeve, krahasuar me një vit më parë, ndaj ndryshimit të vlerës së drejtë të instrumenteve për investime të hapura, risku i çmimit vazhdon të jetë faktori më i rëndësishëm i riskut direkt ndaj aseteve të investuara të FKPK-MP. FKPK-MP përmes politikës së investimeve tenton të menaxhojë këtë risk duke shpërndarë investimet në instrumente për investime të hapura pa korreleacion me njëra-tjetër, e që në portofolet e tyre investuese kanë klasa të ndryshme të instrumenteve financiare si dhe qasje dhe objektiva të ndryshme investuese.

*Analiza e ndryshimeve ndaj ndryshimit të çmimit të investimeve në instrumente të hapura*

Sikur çmimet e instrumenteve për investime të hapura të ishin 5% më të larta/ulëta në datën e raportimit, atëherë mjetet neto të pjesëmarrësve do të rriteshin me 32,544,256 euro, ose do të uleshin me 32,538,061 euro (2012 respektivisht: do të rriteshin me 34,770,707 euro ose do të uleshin me 31,461,440).

*Analiza e ndryshimeve ndaj ndryshimit të çmimit të aksioneve në kuadër të instrumenteve të hapura*

Vlera e drejtë e aksioneve në portofolet e instrumenteve për investime të hapura në ishte 404,325,510 euro, ose 44.3% e mjeteve të FKPK-MP (2012: 357,202,310 euro ose 48.3%). Risku i çmimit të aksioneve në portofolet e instrumenteve për investime hapura është shumë më i ulët se risku direkt i çmimeve i vet instrumenteve për investime të hapura, pasi që ndikimi në datën e raportimit i rritjes/uljes prej 5% në çmimin të aksioneve në këto investime indirekte do të bënte që mjetet neto të pjesëmarrësve respektivisht: të rriten me 19,305,378 euro ose të bien me 19,301,131 euro (2012 respektivisht: të rriteshin me 18,831,948 euro ose të uleshin me 16,673,962 euro).

##### 3.8.5 Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjes financiare të FKPK-së nëse një klient apo pala tjetër nuk kryen detyrimet e tij kontraktuale. Asetet e FKPK-MP i janë ekspozuar direkt vetëm instrumenteve të borxhit të Thesarit të Kosovës, të cilat ende mbesin pa rejting, megjithatë, sikurse Ligji në fuqi që i klasifikon instrumentet e borxhit publik në kategorinë e dorës së parë, edhe FKPK-MP bënë të njejten gjë në analizën e ekspozimit direkt dhe indirekt në portofolet e instrumenteve për investime të hapura, të ekspozuara ndaj riskut kreditor.

FKPK-MP e konsideron rrezikun e kredisë si shumë të ulët për investimet e KPST-MP duke pasur parasysh diversifikimin shumë të madh në emetues të ndryshëm si dhe vlerësimin e instrumenteve të borxhit në përbërjen e instrumenteve për investime të hapura.

Në vijim është paraqitur rejtingu i instrumenteve për investime të hapura ose menaxhuesve të tyre, tek të cilët FKPK-MP kishte investime më 31 dhjetor 2013.

Fondi	Rejtingu	Përshkrimi i rejtingut
<b>Vanguard – GSIF</b>	<b>Nuk ka rejting</b>	-
<b>AXA – GILB</b>	<b>Argjend</b> Rejtingu i fondit nga S&P	Fondi demonstroi standarde të larta të cilësisë në sektorin e vet, bazuar në proceset e investimit dhe konsistencën e performancës nga menaxhmenti në krahasim me fondet tjera me objektiva të ngjashme.
<b>BNY Mellon – RRF</b>	<b>Platin</b> Rejtingu i fondit nga S&P	Fondi demonstroi standardet më të larta të cilësisë në sektorin e vet, bazuar në proceset e investimit dhe konsistencën e performancës nga menaxhmenti në krahasim me fondet tjera me objektiva të ngjashme.
<b>Aquila – RP7</b>	<b>Ar</b> Rejtingu i fondit nga S&P	Fondi demonstroi standardet më të larta të cilësisë në sektorin e vet, bazuar në proceset e investimit dhe konsistencën e performancës nga menaxhmenti në krahasim me fondet tjera me objektiva të ngjashme.
<b>Schroders – SISF</b>	<b>Superior</b> Rejtingu i menaxhuesit nga Fitch	Operacionet e menaxhuesit demonstrojnë dobësinë më të ulët ndaj dështimeve të menaxhimit operacional dhe investues.
<b>ECM – DEC</b>	<b>BBB-</b> Rejtingu i menaxhuesit nga Fitch	I mesëm i ulët

#### 4 PARAJA NË BANKË

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës	209,646,903	27,328,138
<b>Gjithsej paraja në bankë</b>	<b>209,646,903</b>	<b>27,328,138</b>

#### 5 KONTRIBUTE DHE TË TJERA TË ARKËTUESHME

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Kontributet e arkëtueshme	7,869,239	7,733,747
Rabatet e arkëtueshme nga fondet për investime të hapura	-	57,340
<b>Gjithsej kontribute dhe të tjera të arkëtueshme</b>	<b>7,869,239</b>	<b>7,791,087</b>

Kontributet e arkëtueshme kanë të bëjnë me kontributet e pranuar në llogarinë rrjedhëse në BQK deri më datën 18 të muajit vijues (2012: deri më datën 18) dhe të cilat nuk janë shndërruar në aksione në datën e raportimit.

#### 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
		EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	313,444,532	272,937,641
BNY Mellon – RRF	6.2	133,139,594	83,960,682
AXA – GILB	6.3	57,478,701	115,609,533
Schroders – SISF	6.4	96,379,844	64,758,425
Aquila – RP7	6.5	26,986,630	73,938,085
State Street – EMIF	6.6	-	33,028,458
ECM – DEC	6.7	23,403,320	22,086,565
<b>Gjithsej investimet e disponueshme për shitje</b>		<b>650,832,621</b>	<b>666,319,389</b>

#### 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

##### 6.1 Vanguard Investment Series plc – Global Stock Index Fund Euro hedged (ISIN IE00B03HD316)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>25,211,077</b>	<b>272,937,641</b>	<b>21,477,270</b>	<b>203,454,179</b>
Investimet e reja gjatë vitit	3,205,132	42,000,000	3,677,726	37,600,000
Tërheqjet gjatë vitit	(5,803,337)	(75,000,000)	-	-
Re-investimi i rabateve	65,824	818,992	56,081	578,666
Rivlerësimi – Rritja	-	73,873,421	-	32,253,908
Tarifat e ngarkuara	-	(1,185,522)	-	(949,112)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>22,678,696</b>	<b>313,444,532</b>	<b>25,211,077</b>	<b>272,937,641</b>

Ky fond kërkon të sigurojë rritjen afatgjate të kapitalit duke ndjekur performancën e Morgan Stanley Capital International (MSCI) World Free Index (indeksi), indeks ky i peshuar dhe bazuar në madhësinë e kapitalit të kompanive në vendet e zhvilluara. Politika e investimeve e Global Stock Index Fund është që kryesisht të investohet në aksione të zakonshme. Investimet e FKPK-së në këtë fond blejnë aksione sipas Vlerës Neto të Mjeteve (VNM) për aksion në ditën relevante të afazimit. Ky fond nuk paguan dividendë, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM. Kthimi neto për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte 27.66% (2012: 14.28%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë me normë vjetore prej 0.25% (2012: 0.40%; 1 janar – 2 dhjetor 2013: 0.40%) të mjeteve me fondin. Fondi po ashtu ofron rabat prej 48.0% në tarifën menaxhuese (2012: 62.5%; 1 janar – 2 dhjetor 2013: 67.5%) e cila re-investohet në muajin pasardhës, gjë e cila bën që tarifa neto menaxhuese që ngarkon fondin të jetë 0.13% (2012: 0.15%) e mjeteve në vit. Nga tërheqjet nga fondin janë realizuar fitime gjatë vitit prej 15,608,172 euro.

##### 6.2 BNY Mellon – Real Return Fund (ISIN IE00B504KX99)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>77,533,181</b>	<b>83,960,682</b>	<b>48,871,078</b>	<b>50,361,646</b>
Investimet e reja gjatë vitit	39,987,866	45,000,000	28,662,103	30,500,000
Rivlerësimi – Rritja	-	4,178,912	-	3,099,036
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>117,521,047</b>	<b>133,139,594</b>	<b>77,533,181</b>	<b>83,960,682</b>

Më 31 dhjetor 2013 investimet e FKPK-MP në BNY Mellon Real Return Fund përbëheshin nga 117,521,047 aksione. Ky fond është instrument i kthimit absolut i cili i investon mjetet pjesërisht në fletobligacione dhe pjesërisht në aksione. Fondi nuk paguan dividendë, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM të fondit. Kthimi vjetor për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte 4.62% (2012: 5.08%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë sipas normës vjetore prej 0.70% të mjeteve me fondin dhe paguhet ndaras nëpërmes faturës, d.m.th. nuk e redukton VNM-në; mirëpo me efekt nga 1 janari 2013, kur bilanci i shumave nominale të investuara në cilëndo ditë është 100 milionë euro ose më shumë, norma e tarifës së menaxhimit bie në 0.60% të mjeteve. Gjithsej tarifat që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2013 kapin shumën prej 763,930 euro (2012: 485,001 euro).



## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.3 AXA – Global Inflation Linked Bonds Eur (ISIN LU0227145629)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>813,865</b>	<b>115,609,533</b>	<b>631,954</b>	<b>84,909,413</b>
Investimet e reja gjatë vitit	68,885	10,000,000	181,911	25,500,000
Tërheqjet gjatë vitit	(449,472)	(60,000,000)	-	-
Re-investimi i rabateve	262	35,263	-	-
Rivlerësimi – Rritja/(Zvogëlimi)	-	(7,693,843)	-	5,586,105
Tarifat e ngarkuara	-	(472,252)	-	(385,985)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>433,540</b>	<b>57,478,701</b>	<b>813,865</b>	<b>115,609,533</b>

Më 31 dhjetor 2013 FKPK-ja në fondin AXA Global Inflation Linked Bonds Eur kishte një numër prej 433,540 aksionesh. Fondi është një instrument i kthimit absolut që pjesën dërrmuese të mjeteve i investon në bono të mbrojtura nga inflacioni të emetuara nga shtetet sovraane dhe korporatat. Fondi nuk paguan dividendë, kështu që të gjitha përfitimet reflektohen në VNM. Kthimi vjetor neto për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte -6.67% (2012: 5.72%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë me një normë vjetore prej 0.40% (2012: 0.40%) të mjeteve me fondin; mirëpo me efekt nga 1 maji 2013 kur vlera e mjeteve është më e lartë se 50 milionë euro, ofrohet rabati në normë vjetore prej 5% të mjeteve me fondin i cili përlogaritet në baza ditore dhe re-investohet në muajin e ardhshëm, duke bërë kështu që tarifa neto menaxhuese të jetë 0.35% e mjeteve në vit. Tërheqjet e mjeteve nga ky fond kanë rezultuar në realizimin e fitimeve në vlerë prej 3,735,179 euro.

### 6.4 Schroders – International Strategic Bond Euro Hedged (ISIN LU0201324265)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>438,594</b>	<b>64,758,425</b>	<b>438,594</b>	<b>59,964,591</b>
Investimet e reja gjatë vitit	200,445	30,000,000	-	-
Rivlerësimi - Rritja	-	1,621,419	-	4,793,834
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>639,039</b>	<b>96,379,844</b>	<b>438,594</b>	<b>64,758,425</b>

Schroders International Strategic Bond është fond i përbashkët me seli në Luksemburg i cili operon përmes investimeve në bono dhe instrumente tjera financiare me kthim fiks apo variabil të denominuara në valuta të ndryshme që emetohen nga qeveritë, agjencitë qeveritare, agjencitë mbikombëtare dhe korporatat gjithandej nëpër botë. Fondi nuk paguan dividendë, kështu që të gjitha përfitimet reflektohen në çmimin ofertues të fondit. Kthimi vjetor për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte 2.15% (2012: 7.99%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet në fund të çdo tremujori me normë vjetore prej 0.50% të mjeteve (2012: 0.50%), dhe paguhet veçmas përmes faturës, pra që nuk e redukton VNM-në. Megjithatë, me efekt nga 1 maji 2013, kur vlera e mjeteve me fondin është më e lartë se 100 milionë euro, norma vjetore e tarifës bie në 0.45% të aseteve, gjë që nuk u aplikua gjatë vitit 2013. Gjithsej tarifata që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2013 kapin shumën prej 453,392 euro (2012: 312,575 euro).

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.5 Aquila – AC Risk Parity 7 Fund (ISIN LU0554703917)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>685,082</b>	<b>73,938,085</b>	<b>493,731</b>	<b>50,641,026</b>
Investimet e reja gjatë vitit	92,885	10,000,000	191,351	20,000,000
Tërheqjet gjatë vitit	(511,815)	(52,000,000)	-	-
Rivlerësimi – Rritja/(Zvogëlimi)	-	(4,951,455)	-	3,297,059
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>266,152</b>	<b>26,986,630</b>	<b>685,082</b>	<b>73,938,085</b>

Deri më 31 dhjetor 2013 FKPK-MP kishte 266,152 aksione në AC Risk Parity 7 Fund të Aquila Capital. Fondi është një instrument i kthimit absolut që pjesën dërrmuese të mjeteve i investon në fletobligacione me rejting shumë të lartë, ndërkaq pjesën tjetër në kontrata në avans të indekseve të fletobligacioneve dhe aksioneve për qëllime të mbrojtjes nga risqet. Fondi nuk paguan dividendë, andaj të gjitha përfitimet reflektohen në VNM të fondit. Kthimi vjetor për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte -6.05% (2012: 5.22%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë sipas normës vjetore prej: 1.06% të mjeteve kur shumat e investuara janë nën 50,000,000 euro; 0.96% të mjeteve kur shumat e investuara ishin në mes të 50,000,000 euro dhe 79,999,999 euro; 0.79% të mjeteve kur shumat e investuara ishin në mes të 80,000,000 euro dhe 99,999,999 euro (2012: 0.96% të mjeteve) dhe paguhet ndarazi nëpërmes faturës, që d.m.th. se nuk e redukton VNM-në. Gjithsej tarifata që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2013 kapin shumën prej 625,429 euro (2012: 633,154 euro). Tërheqjet e mjeteve nga ky fond kanë rezultuar në realizimin e humbjeve në vlerë prej 631,016 euro.

### 6.6 State Street – Emerging Markets Equity Index Fund (jo i listuar)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>1,779,079</b>	<b>33,028,458</b>	-	-
Investimet e reja gjatë vitit	-	-	1,779,079	31,400,000
Rivlerësimi – Rritja/(Zvogëlimi)	-	(930,259)	-	1,628,458
Tërheqjet gjatë vitit	(1,779,079)	(32,098,199)	-	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,779,079</b>	<b>33,028,458</b>

Më 24 tetor 2013 FKPK-ja tërhoqi të gjitha mjetet që kishte në State Street Global Advisors (SSGA) Emerging Markets Equity Index Fund i cili ndjek performancën e MSCI Emerging Markets Equity Index Fund. Fondi nuk paguan dividendë, kështu që të gjitha përfitimet reflektohen në VNM të fondit. Kthimi për vitin prej 1 janar deri më 24 tetor 2013 ishte -2.82% (2012: 5.34%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë sipas normës vjetore prej 0.20% të mjeteve (2012: 2.20% të mjeteve), dhe paguhet çdo tremujor përmes faturës, që d.m.th. nuk reduktohet VNM. Gjithsej tarifata që janë ngarkuar nga menaxhuesi i fondit për fund vitin 31 dhjetor 2013 kapin shumën prej 51,450 euro (2012: 52,168 euro). Tërheqjet e të gjitha mjeteve nga ky fond kanë rezultuar në realizimin e fitimeve në vlerë prej 698,199 euro.

## 6 INVESTIMET E DISPONUESHME PËR SHITJE (VAZHDIM)

### 6.7 European Credit Management Ltd – Diversified European Credit (ISIN XS0306910752)

	2013		2012	
	Aksione	EUR	Aksione	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>252,550</b>	<b>22,086,565</b>	<b>252,550</b>	<b>19,980,969</b>
Rivlerësimi – Rritja	-	1,429,999	-	2,211,981
Tarifat e ngarkuara	-	(113,244)	-	(106,385)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>252,550</b>	<b>23,403,320</b>	<b>252,550</b>	<b>22,086,565</b>

Deri më 31 dhjetor 2013 investimet e FKPK-MP në tregjet e fletobligacioneve dhe kredisë përmes portofolit Diversified European Credit të ECM-së, menaxhues ky i mjeteve me seli në Londër, kanë numëruar 252,550 aksione. Ky është fond aktiv që gjurmon ofertat më të mira në tregjet e fletobligacioneve dhe të kredive, dhe ka luhatsmëri më të lartë se sa investimet tjera të FKPK-së. Fondi nuk paguan dividendë dhe të gjitha fitimet reflektohen në VNM të fondit. Kthimet vjetore neto për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte 4.85% (2012: 10.54%). Tarifa e menaxhimit kalkulohet çdo ditë me normë vjetore prej 0.50% të mjeteve (2012: 0.50%), plus një tarifë të ndryshueshme të bazuar në performancën e fondit krahas Euribor-it.

### 6.8 Tarifat dhe rabatet e instrumenteve për investime të hapura

		Për fund vitin 31 dhjetor 2013			Për fund vitin 31 dhjetor 2012		
		Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto	Tarifa bruto	Rabatet	Tarifa neto
		EUR	EUR	EUR	EUR	EUR	EUR
Vanguard – GSIF	6.1	1,185,522	(789,074)	396,448	949,112	(593,188)	355,924
BNY Mellon – RRF	6.2	763,930	-	763,930	485,001	-	485,001
AXA – GILB	6.3	472,252	(39,207)	433,045	385,985	-	385,985
Schroders – SISF	6.4	453,392	-	453,392	312,575	-	312,575
Aquila – RP7	6.5	625,429	-	625,429	633,154	-	633,154
State Street – EMIF	6.6	51,450	-	51,450	52,168	-	52,168
ECM – DEC	6.7	113,244	-	113,244	106,385	-	106,385
BNP Paribas – GLF <sup>1</sup>		-	-	-	53,264	-	53,264
<b>Gjithsej tarifa e rabate</b>		<b>3,665,219</b>	<b>(828,281)</b>	<b>2,836,938</b>	<b>2,977,644</b>	<b>(593,188)</b>	<b>2,384,456</b>

<sup>1</sup> Gjatë 2012 FKPK ka tërhequr në tërësi investimet në instrumentin BNP Paribas Global Liquidity Fund.

## 7 INVESTIMET NË DEPOZITA BANKARE

	2013	2012
	EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>16,428,599</b>	<b>15,855,128</b>
Interesi	173,172	573,471
Tërheqja e depozitave	(16,601,771)	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>16,428,599</b>

Gjatë vitit 2013 FKPK tërhoqi të gjitha depozitat e FKPK-MP me NLB Prishtina. Depozitat kishin interes vjetor prej 3.50% (2012: 3.50%) të ponderuar çdo muaj, me 16,500,000 euro të garantuara përmes bonove të Thesarit të vendeve anëtare të OBZHE-së. Interesi paguhej/re-investohej në ditën e fundit të secilit muaj.

## 8 INVESTIMET QË MBAHEN DERI NË MATURIM

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
		EUR	EUR
Raiffeisen Bank Kosovo	8.1	-	16,120,085
Instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës	8.2	53,122,905	13,928,911
<b>Gjithsej investimet që mbahen deri në maturim</b>		<b>53,122,905</b>	<b>30,048,996</b>

### 8.1 Raiffeisen Bank Kosovo

	2013	2012
	EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>16,120,085</b>	<b>18,844,793</b>
Interesat e re-investuar/të përlllogaritur	81,895	412,216
Tërheqjet e afatizimeve	(16,201,980)	(3,136,924)
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>16,120,085</b>

Gjatë vitit 2013, me kërkesë të Raiffeisen Bank Kosovo, kontrata e afatizimeve është ndërprerë para datës origjinale të maturimit më 11 qershor 2013, dhe të gjitha mjetet u tërhoqën nga FKPK-ja. Norma vjetore e interesit të këtyre depozitave ishte 2.20% (2012: 2.20%), e ponderuar në baza mujore dhe dhe me interes të re-investuar çdo muaj. Depozitat me afat ishin të garantuara me fletobligacione të Thesareve të shteteve anëtare të OBZHE-së.

## 8 INVESTIMET E MBAJTURA DERI NË MATURIM (VAZHDIM)

### 8.2 Instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës

	2013	2012
	EUR	EUR
<b>Më 1 janar</b>	<b>13,928,911</b>	-
<b>Plasmanet</b>		
KV1100820084 T-Bill Mat. 23.01.2013 @3.05%	-	12,487,364
KV1101120114 T-Bill Mat. 20.03.2013 @2.36%	-	1,264,888
KV1102820282 T-Bill Mat.19.02.2014 @1.49%	9,925,301	-
KV1103020305 T-Bill Mat. 19.03.2014 @1.24%	1,719,262	-
KV1102140211 T-Bill Mat. 23.04.2014 @2.26%	11,546,252	-
KV1103420343 T-Bill Mat. 21.05.2014 @1.20%	14,909,512	-
KV1103240327 T-Bill Mat. 22.10.2014 @1.98%	14,705,355	-
	<b>52,805,682</b>	<b>13,752,252</b>
<b>Interesat</b>		
KV1100820084 T-Bill Mat. 23.01.2013 @3.05%	24,507	168,129
KV1101120114 T-Bill Mat. 20.03.2013 @2.36%	6,582	8,530
KV1102820282 T-Bill Mat.19.02.2014 @1.49%	54,121	-
KV1103020305 T-Bill Mat. 19.03.2014 @1.24%	6,128	-
KV1102140211 T-Bill Mat. 23.04.2014 @2.26%	181,232	-
KV1103420343 T-Bill Mat. 21.05.2014 @1.20%	20,337	-
KV1103240327 T-Bill Mat. 22.10.2014 @1.98%	55,405	-
	<b>348,312</b>	<b>176,659</b>
<b>Tërheqjet (pas maturimit)</b>		
KV1100820084 T-Bill Mat. 23.01.2013 @3.05%	(12,680,000)	-
KV1101120114 T-Bill Mat. 20.03.2013 @2.36%	(1,280,000)	-
	<b>(13,960,000)</b>	-
<b>Më 31 dhjetor</b>	<b>53,122,905</b>	<b>13,928,911</b>

Fletobligacionet e Thesarit të Kosovës ende nuk kanë rejting. Është synim i Bordit Drejtues që të mbajë deri në maturim investimet e FKPK-MP në instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës.

## 9 DETYRIMET NDAJ OPERACIONEVE TË FKPK-SË

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve – të pagueshme	292,357	290,047
Diferenca nga refondimet e kontributeve të gabuara – të pagueshme	1,653	124,259
<b>Gjithsej detyrimet ndaj operacioneve të FKPK-së</b>	<b>294,010</b>	<b>414,306</b>

Më 31 dhjetor 2013 bilanci i tarifës së pagueshme në vlerë prej 292,357 euro ka të bëjë me tarifën e FKPK-së të ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve të cilat nuk u transferuan tek operacionet e FKPK-së deri në datën e raportimit (31 dhjetor 2012: 290,047 euro të përbëra nga 232,706 euro për tarifën e FKPK-së si dhe 57,341 euro për rabatet e akumuluar të instrumenteve për investime të hapura).

Kur një kontribut pensional dëshmohej se është arkëtuar gabimisht, vlera nominale i refondohet paguesit. Sipas politikave të FKPK-së të hyra në fuqi prej 1 janarit 2012, ndryshimi në mes të vlerës së refonduar dhe vlerës së aksioneve të riblera në ditën e refondimit, trajtohet si të hyra tjera (ose shpenzime tjera) për operacionet e FKPK-së. Para 1 janarit 2012 këto ndryshime janë reflektuar në çmimin për njësi të fondit të mjeteve pensionale.

## 10 DETYRIMET PËR AKSIONET E RIBLERA

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Detyrimet për refondime	73,620	9,324
Detyrimet për tërheqje të kursimeve	38,727	-
<b>Gjithsej detyrime për aksionet e riblera</b>	<b>112,347</b>	<b>9,324</b>

Deri më 31 dhjetor 2013 bilanci i mjeteve pensionale të shpenguara përmes refondimeve dhe tërheqjeve të kursimeve (pagesave të benefiteve) të cilat nuk ishin transferuar tek përfuturit përkatës deri në datën e raportimit ishte 112,347 euro (2012: 9,324 euro).

## 11 JO-KONTRIBUTET

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Jo-kontributet	13,334	4,892
<b>Gjithsej jo-kontribute</b>	<b>13,334</b>	<b>4,892</b>

Transferet hyrëse në llogarinë e FKPK-së në BQK për grumbullim të mjeteve, të cilat në momentin e procesimit të ekstraktit bankar identifikohen si arkëtime të gabuara dhe nuk janë kontribute pensionale, klasifikohen si jo-kontribute dhe për to nuk emetohen aksione. Në të gjitha rastet e tjera për transferet hyrëse të kontributeve fillimisht emetohen aksione, e më pas refondohen nëse dëshmohej të kenë qenë arkëtime të gabuara. Më 31 dhjetor 2013 bilanci i jo-kontributeve të pa kthyer ishte 13,334 euro (2012: 4,892 euro).

## 12 RIVLERËSIMI I INVESTIMEVE TË DISPONUESHME PËR SHITJE – NETO

Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012	
	EUR	EUR	
Vanguard – GSIF	6.1	73,873,421	32,253,908
BNY Mellon – RRF	6.2	4,178,912	3,099,036
AXA – GILB	6.3	(7,693,843)	5,586,105
Schroders – SISF	6.4	1,621,419	4,793,834
Aquila – RP7	6.5	(4,951,455)	3,297,059
State Street – EMIF	6.6	(930,259)	1,628,458
ECM – DEC	6.7	1,429,999	2,211,981
BNP Paribas – GLF <sup>1</sup>		-	143,740
<b>Rritja neto për vitin nga rivlerësimi i investimeve të disponueshme për shitje</b>		<b>67,528,194</b>	<b>53,014,121</b>

<sup>1</sup>Gjatë 2012 FKPK ka tërhequr në tërësi investimet në instrumentin BNP Paribas Global Liquidity Fund.

## 13 TË HYRAT NGA INTERESI I INVESTIMEVE QË MBAHEN DERI NË MATURIM

Shënime	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012	
	EUR	EUR	
Raiffeisen Bank Kosovo	8.1	81,895	412,216
Instrumentet e borxhit të Thesarit të Kosovës	8.2	348,312	176,659
<b>Gjithsej të hyrat nga interesi i investimeve që mbahen deri në maturim</b>		<b>430,207</b>	<b>588,875</b>

## 14 TË HYRAT NGA INTERESI I LLOGARIVE RRJEDHËSE

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	-	7,603
<b>Gjithsej të hyrat nga interesi i llogarive rrjedhëse</b>	<b>-</b>	<b>7,603</b>

Llogaria rrjedhëse (grumbulluese) e FKPK-MP në BQK nuk paguan interes që nga data 12 korrik 2012. Para kësaj date interesi ishte përlllogaritur në baza ditore mbi bilancin e llogarisë me një normë vjetore të interesit prej 0.10% nga 1 janari deri më 10 prill 2012, dhe normën vjetore prej 0.05% nga 11 prilli deri më 11 korrik 2012.

## 15 TË HYRAT E TJERA

Bordi Drejtues i FKPK ka vendosur t'i rimburojë 3,000,000 euro nga suficitet e KPST Operacioneve tek mjetet pensionale. Transaksioni u ekzekutua në dhjetor 2013.

## 16 TARIFAT E NGARKUARA MBI LLOGARITË E PJESËMARRËSVE

	Për fund vitin 31 dhjetor 2013	Për fund vitin 31 dhjetor 2012
	EUR	EUR
Tarifa për aktivitetet e përbashkëta	1,796,645	3,997,932
Tarifa për aktivitetet investuese	2,009,569	-
Tarifa për aktivitetet operacionale	793,250	-
<b>Gjithsej tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve</b>	<b>4,599,464</b>	<b>3,997,932</b>

Tarifat llogariten në baza ditore sipas formulës:

Tarifa = [Mjetet bruto të pjesëmarrësve] \* [Norma]/[Numri i ditëve kalendarike në vit].

Gjithsej tarifa e ngarkuar mbi mjetet bruto të pjesëmarrësve me qëllim të financimit të aktiviteve të FKPK-së për fund vitin 31 dhjetor 2013 ishte 4,599,464 euro (2012: 3,997,932 euro).

Para Ligjit Nr. 04/L-168 një tarifë e vetme (tarifë e përbashkët e menaxhimit) ngarkohej për financimin e aktiviteve të përbashkëta, pra aktivitetet investuese dhe operacionale. Megjithatë, ky ligj krijoi dy tarifa të veçanta: (i) tarifën për mbulimit e aktiviteve që kanë të bëjnë me investimin e mjeteve pensionale dhe (ii) tarifën për mbulimin e aktiviteve operacionale.

Nga 1 janari 2012 deri më 19 maj 2013, tarifa e përbashkët e menaxhimit u ngarkua me normë vjetore prej 0.60%. Nga 20 maji 2013 kur Kuvendi i Republikës së Kosovës – sipas ligjit të ri – aprovoi tarifën për aktivitetet investuese me një normë vjetore prej 0.38%, si dhe tarifën për aktivitetet operacionale me normë vjetore prej 0.15%, FKPK ngarkoi tarifat sipas normave të reja si dhe bëri ndarjen në kontabilitet të aktiviteve investuese dhe atyre operacionale.

## 17 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE

	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
	Numri i llogarive	Numri i llogarive
Llogari pa tërheqje të kursimeve	426,756	401,128
Llogari me tërheqje të kursimeve	20,503	16,936
<b>Gjithsej llogari</b>	<b>447,259</b>	<b>418,064</b>

Një llogari me tërheqje të kursimeve paraqet llogaritë e kursimeve pensionale prej të cilave janë tërhequr kursimet pensionale për shkak se: (i) pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit 65 vjeçare ose është bërë i paaftë për punë, ose (ii) pasardhësit, të konsideruar si trashëgimtarë të ligjshëm, kanë trashëguar kursimet pensionale të pjesëmarrësit të vdekur. Nga 447,259 pjesëmarrësit për të cilët FKPK-ja e kishte hapur një llogari të kursimeve pensionale deri në datën e raportimit, 277,305 sosh kishin kontribute që i përkisnin fund vitit 31 dhjetor 2013 (31 dhjetor 2012: 266,026 nga 418,064 llogari të hapura).

## 17 LLOGARITË INDIVIDUALE TË PJESËMARRËSVE (VAZHDIM)

Kontributet në FKPK paguhen nga punëdhënësit në emër të të punësuarve të cilët janë residentë të Kosovës, me normën e kontributit prej së paku 5% të të ardhurave bruto të punonjësit për të dy, punëdhënësin dhe të punësuarin. Së bashku me kontributet vullnetare, maksimumi që punëdhënësi dhe i punësuarit secili mund të kontribuojnë është 15% e të ardhurave bruto të punonjësit.

Punëdhënësit kanë për obligim të ngarkojnë në portalin e ATK-së listën e pagave në mënyrë që të sigurojnë fletëpagesën për një muaj të caktuar. Të vetëpunësuarit i bëjnë pagesat në baza tremujore. ATK-ja i mundëson FKPK-së të ketë qasje në këto shënime duke qenë gjithashtu përgjegjëse për përmbushjen e obligimeve të punëdhënësve, si dhe për sforcimin e përmbushjes përmes lëshimit të gjobave ndaj punëdhënësve delikuentë.

Kryesisht për shkak të natyrës jo të përsosur të procesit të mbledhjes dhe raportimit që ishte në fuqi para tremujorit të katërt të vitit 2012, kur u shfaq portali, fondet e mbledhura nuk alokoheshin plotësisht në llogaritë individuale të pjesëmarrësve. Që nga koha kur portali u shfaq shumica dërrmuese e kontributeve janë duke u alokuar në llogaritë individuale në të njëjtën ditë kur pagesat procesohen. Kryesisht për shkak të mos-raportimit të punëdhënësve për periudhat e mëparshme, shuma prej 12,849,215 euro nuk u ishte shpërndarë llogarive individuale të pjesëmarrësve deri më 31 dhjetor 2013 (31 dhjetor 2012: 17,544,647 euro).

Gjatë vitit 2013 FKPK alokoi shumën prej 4,575,373 euro në llogaritë individuale nga shuma që ishte e pa alokuar deri më 31 dhjetor 2012.

Natyrë dhe arsyet e mos alokimit të kontributeve në llogaritë individuale të pjesëmarrësve prezantohet më poshtë:

Arsyet	Më 31 dhjetor 2013 EUR	Më 31 dhjetor 2012 EUR
Punëdhënësit nuk kanë dorëzuar raportin e kontributeve	11,269,000	15,473,692
Pagesa nuk është alokuar në konto të punëdhënësit	1,022,564	1,490,817
Kombinime jo valide të Nr. personal dhe emrit të pjesëmarrësit	557,651	580,138
<b>Gjithsej kontribute të pa alokuara</b>	<b>12,849,215</b>	<b>17,544,647</b>
Kontributet kumulative të njësuara deri në datën e raportimit	844,639,632	725,483,382
<b>Kontributet e pa alokuara si përqindje e kontributeve të njësuara deri në datën e raportimit</b>	<b>1.5%</b>	<b>2.4%</b>

Një metodë tjetër e vrojtimit të progresit të procesit të alokimit është krahasimi i fondeve të alokuara dhe mjeteve neto nën menaxhim të njësuara, si në vijim.

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013 Vlera në EUR	Më 31 dhjetor 2012 Vlera në EUR
Mjetet neto të pjesëmarrësve		921,051,977	747,487,687
Kontributet e arkëtueshme të panjësuar në datën e raportimit	5	(7,869,239)	(7,733,747)
<b>Mjetet neto të njësuara të pjesëmarrësve</b>		<b>913,182,738</b>	<b>739,753,940</b>
Bilanci i fondeve në llogaritë individuale		898,282,029	720,926,504
<b>Përqindja e mjeteve neto të njësuara të pjesëmarrësve në llogaritë individuale</b>		<b>98.4%</b>	<b>97.5%</b>

## 18 TËRHEQJA NË FAZA E BENEFITEVE

Sipas Udhëzimit Administrativ të janarit 2013 të BQK-së, pjesëmarrësit që në momentin e përfitimit të pensionit kanë në llogaritë e tyre në FKPK më shumë se 2,000 euro duhet t'i tërheqin kursimet e tyre në faza. Pjesëmarrësit pranojnë pagesa mujore në shumën prej 1% të vlerës së përgjithshme të llogarisë së tyre në momentin e pensionimit ose 150 euro, cilado që është më e lartë (2012: 1% e vlerës së përgjithshme ose 100 euro, cilado që është më e lartë, sipas udhëzimit administrativ të BQK-së të janarit 2008). Udhëzimi do të vlejë përderisa anuitetet nuk ofrohen në Kosovë. Në momentin e pensionimit i gjithë bilanci i llogarisë së pjesëmarrësit në FKPK do të transferohet në bankën komerciale të kontraktuar për të ofruar shërbimin e tërheqjes në faza, dhe kështu mjetet e tilla nuk llogariten më si mjete të FKPK-MP-së. Personat që në momentin e pensionimit kanë bilanc më të ulët se 2,000 euro vazhdojnë t'i përfitojnë kurisimet në një pagesë të vetme.

## 19 PASQYRA E LËVIZJEVE TË AKSIONEVE TË PJESËMARRËSVE

	Shënime	2013 #	2012 #
<b>Më 1 janar</b>		<b>662,262,094</b>	<b>568,472,223</b>
Aksionet e emtuara për kontributet e arkëtuar		101,884,208	104,467,613
Aksionet e riblera për shkak të tërheqjeve të kursimeve		(9,207,956)	(8,017,929)
Aksionet e riblera për shkak të refondimeve		(1,287,954)	(2,659,813)
<b>Më 31 dhjetor</b>		<b>753,650,392</b>	<b>662,262,094</b>
Neto mjetet e njësuara të pjesëmarrësve	17	913,182,738	739,753,940
<b>Vlera e mjeteve neto për aksion në datën e raportimit</b>		<b>EUR 1.2117</b>	<b>EUR 1.1170</b>

## 20 NGJARJET PAS PERIUDHËS SË RAPORTIMIT

Për dy muajt e parë të vitit 2014 FKPK i kishte këto të dhëna financiare të bazuara në pasqyrat e paaudituar financiare për këta dy muaj.

	<b>Më 28 shkurt 2014</b>
	EUR
Gjithsej mjete	944,845,835
Gjithsej detyrime (afat-shkurtër)	(431,714)
<b>Mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>944,414,121</b>
	<b>Për periudhën 1 janar deri 28 shkurt 2014</b>
	EUR
Fitimi dhe interesat nga rivlerësimi i investimeve	8,673,614
Tarifat e ngarkuara mbi llogaritë e pjesëmarrësve	(789,069)
<b>Rritja në mjetet neto të pjesëmarrësve</b>	<b>7,884,545</b>

Nuk ka ngjarje të mëvonshme që do të kërkonin korrigjim ose shpalsje të mëtejshme në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013.

**Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës**

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

T: 381 38 244 341

F: 381 38 244 368

[info@trusti.org](mailto:info@trusti.org)

[www.trusti.org](http://www.trusti.org)